



KUVENDI KOMUNAL - DEÇAN

Municipal Assembly of Decan

TRANSKRIPTI

DECANI

Mbledhjen e Kuvendit të Komunës

(Legjislatura e VII , mbledhja e VII) me dt.29.09.2025



DEÇAN

e Hëne, 29 Shtator 2025

Hajdar Sutaj

Kryetar Bashkim Ramosaj, kolegë anëtarë të Kuvendit Komunal, përfaqesues të OSBE-së, e hapi takimin e shtatë të rregullt të Kuvendit Komunal Deçanit për vitin 2025 edhe për rend të dites propozoj:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i transkriptit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt buxhetit 2026-2028.
3. Njoftimi i Drejtoris së Arsimit për përgatitjen e vitit shkollor 2025-2026.
4. Përkrahjen e Kuvendit të Komunës së Deçanit për deklaraten e datës 19 nëntor 2024 dhe komunikatës mbështetëse të datës 16 korrik 2025 mbi eliminimin e gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe jetën publike në Kosovë.
5. Propozim vendim për këmbimin e pronës komunale me pronë private.
6. Të ndryshme.

Të nderuar koleg pika e parë sa i përket transkriptit, ne nuk e kemi, nuk e kemi transkriptin sepse... Kontrata me kompaninë e cila ka bërë transkriptin ka skaduar, komuna e ka publiku shpalljen kanë ofertuar kompanitë edhe ato janë shty se cilat kanë drejtë për me pas drejtë, për me e krye këtë punë si tillë nuk e kemi transkriptin po ashtu te pika pesë, e kemi diskutuar edhe në Komitetin për Politikë e Financa sa i përket propozim vendimit për këmbimin e pronës komunale me pronë private, një kërkesë e zotërit Xhevdet Mulaj, edhe pse u kompletua materiali, ligji e thotë që "në momentin që presidentja shpall zgjedhjet, komuna nuk ka drejtë të marrë vendime për këmbimin e pronave" dhe ky ka qenë një gabim, të cilin e kam bërë bashkë me sekretaren e Kuvendit, pa konsultim me kryetarin dhe në rekomandim të Komitetit për Politikë e Financa i propozojmë Kuvendit që mu largua. Ndërsa sa i përket pikave tjera të rendit të dites, të të ndryshmet, kemi në material që në Komitetin për Politikë e Financa kemi pajtë që të kenë gjitha grupet nga një, janë disa propozime ndryshime në rregulluarën për sistematizimin e vendit të punës, të cilat janë rekomandime të Ministrisë përkatëse nëse ju do ishit dakort, do ta kishim futur këto të të ndryshmet po gjithsesi, unë e hapi debatin sa i përket rendit të dites, Vatan Istrefaj e ka fjalën.

Vatan Istrefaj

Faleminderit për fjalën kryesues, përshëndetje për gjithë.

I nderuar Kryetar i Komunës, të nderuar kolegë asambleist, ekzekutiv nga Komuna e Deçanit. Kryesues, po ndërlihem pak me transkriptin, po mendoj që është një përgjegjësi nga ana juaj, për shkak se ti e kishit ditë afatin kohor për sa kohë ka qenë kontrata valide. Për këtë arsye, pasi ka përfunduar kontrata, ti është dashur që ti marrësh hapat sa më parë dhe të na tregosh në seancën e kaluar, pasi që ne kemi mundur të shkojmë në një seancë edhe me metodën e vjetër, pra me transkript, faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë Albësa Cacaj, pastaj Mon Selmanaj.

Albësa Cacaj

E njëjta çështje që e konstatoi Vatani e kam edhe unë nuk është hera e parë kjo ka filluar mu bo dukuri mungesa e transkriptit është fakt që ju e keni ditë, momentin që jeni në një marrëveshje ose në një marrëdhënie kontraktuale, fillimin dhe përfundimin, është dashur me ditë kur është përfundimi dhe me i ndërmarrë masat, procedurën, që kuvendi mos me mbetë pa proces verbal. E njëjta dukuri shfaqet edhe te Komiteti për Komunitete aty ne nuk kemi transkript, kemi proces mbajtëse e kemi mbajt, ë, mbledhjen me 15 korrik, me 15 shtator, mu gusht ka qenë pushim domethënë, kur kemi filluar me 15 shtator, nuk ka qenë proces verbali i gatshëm siç e dimë gjithë, e, në proces verbalin i Komitetit për Komunitete është me një vëllim dy, dyfaqësh kur kam kërkuar përgjegjësi, nuk ka dhënë askush qështja tjetër që du me, me e shtrë sot në Kuvend sepse konsideroj që Kuvendi është, duhet me qenë ndijeni edhe qytetarëve si funksionojnë,

funksionojnë komitetet e përhershme ka qenë e ftume edhe e kemi pasë n'plan të, muajt n'plan të punës, të muajt, të komitetit që të jetë e ftume drejtoresha për financa, duke marrë parasysh se ka qenë një pikë tepër e rëndësishme si për komunitetin, si për gjithë qytetarët e komunës së Deçanit dhe drejtoresha nuk ka qenë n'gjendje me marrë pjesë, me propozimin tim, me votimin nga anëtarët e Komitetit për Komunitete, seanca u shty për një ditë tjetër, edhe aty kemi pasë mungesë të proces verbalit veç edhe një sekondë dhe po përfundoj

Hajdar Sutaj

M'fal, m'fal, nuk po du met pengu
a don me shti këtë si pikë me diskutu kete qeshtje Po munden, po me qenë se jemi duke folur vetem per rend dite.

Albesa Cacaj

Po, por ra fjala për transcript, po e përfundoj edhe... njëherësh, unë kam shqetësim realisht është shqetësim.

Hajdar Sutaj

A ben me diskutu tek te dryshmet, Mon Selmanaj e ka fjalën.

Mon Selmanaj

Faleminderit kryesues përshëndetje kryetar përshëndetje për gjithë ju kolegë te nderuar. Mendoj se pjesërisht kryesuesi ka te drejtë ta argumentoj mosardhjen e transkriptit në këtë seancë, pasi që ju, zoti kryesues i keni keni qenë në dijeni kohë më pare është dasht që Sekretaria e Kuvendit të mbajë shënime të mbahet procedurëvali si kur e kemi majt me vite të tjera nuk e shoh të arsyeshme edhe nuk mund ta marr me mend që në një mbledhje të Kuvendit të mos ketë shënime për gjitha gjërat që ndodhin brenda asaj séance diskutimet, vendimet që merr Kuvendi mos jet nesër ni dokument mos jet i arkivum mbi mbi atë që ka ndodh. Prandaj kjo është nje leshim ndoshta i juaji si kryesues spo tham i kryetarit ju faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë e vërteta është që s'ka ajo qysh e thatë te beje kryetari në këtë punë edhe pse me kohe jan nis procedurat eshë blloku si procedurë, po megjithatë ju keni drejtë. Kini drejtë ne kete pikë edhe kërkojë, domethënë edhe publikisht prej sekretarës që t'i merr edhe t'i kqyr këto që si kemi pas transkriptin t'i përcjelli, I kemi video inqizimet edhe në YouTube, edhe në CD që na dorëzuan edhe t'i nxerr procesë verbalet e këtyre mbledhjeve dhe të publikohen gjitha vendimet dhe diskutimet e anëtarëve të Kuvendit në çdo takim që s'ka pas transcript edhe m'vjen keq për këta. Nuk është, nuk është diçka që që nuk mund të ikë çardhje. Sa i përket rendit te dites a keni diçka më shtu? Po urdhero Vatan

Vatan Istrefaj

Falemnderit kryesues, vetëm desha të shtoja që te pikat ndryshme pra aty ku mund të bëjmë pyetje kemi disa pyetje për kryetarin.

Pyetjet që kanë të bëjnë me infrastrukturën, ra me shërbimet publike, po ashtu edhe një kërkesë për drejtorin e shërbimeve publike zotrin Izet Zenuni vetëm desha të deklarohej për rend te dites.

Hajdar Sutaj

Falemnderit shumë, kështu, atëherë në pikën e parë nuk kemi çka të diskutojmë, sepse nuk e kemi. Piken e pestë ram dakort për shkak se nuk kemi përputhje me ligjin mos me diskutu. A jeni dakort për qito pika tjera plus me shti te te ndryshmet diskutimin për rekomandimet që i ka pru Ministria për Rregulloren për Sistematizimin e vendeve te punës.

A jeni dakord me shti në votim veçantë. Po e kuart kush është për, për rend te dites a, ne rregull si pikë e radhës në rregull atëherë kush është për kete rend te dites? A ka kundër? A ka abstinim? Konstatoj që Kuvendi e ka miratue rendin e dites që do ta diskutojmë sot. Vazhdojmë me pikën e dytë, shqyrtimi dhe miratimi i projekti buxhetit vitin 2026 2028. Fillimisht, për fjalën edhe prezantimin e projektbuxhetit, e kisha lut që drejtoresha për Buxhet dhe Financa Dafina Cacaj ta ketë fjalën hyrëse dhe pastaj shefat e grupeve dhe pastaj hapim edhe diskutim edhe për anëtarët e Kuvendit, drejtoresj fjala për ty.

Dafina Cacaj

Falemnderit Kryesues I nderuar kryetar te nderuar perfaqesues te OSBE antar te asambles te nderuar drejtor falemnderit per fjalen buxheti I komunes se Deçanit per vitin 2026 edhe parashikimet per vitin 2027 dhe 2028 siq e kemi diskutuar edhe ne degjimet buxhetore ne te cilat I kemi pasur është planifikuar edhe është aprovuar nga Ministria qe te jet 14.551.974 euro per dallim nga ky vit është diferenca 151.000 euro do te thote është gati I njejt si ne vitin 2025 edhe pse kemi pasur regjistrimin e popullsis mirpo edhe komuna e Deçanit ka nje ramje te numrit te popullsis ministria e ka marr persiper qe me e mbulu minusin e krijuar te disa komuna qe kan popullsin me te vogel qe e kan pas me regjistrimin e vitit 2011, ne kategorit e ndara buxhetin e kemi paga meditje 8.445.561, mallra sherbime 2.000.000, sherbime komunale 300.000, subvencione transfere 350.000, dhe shpenzime kapitale jan 3.456.413, komuna e Deçanit ne drejtorin per shendetesi është e obliguar qe granti I pergjithshem faktikisht ti ndihmoj per 160.000 ne kategorin e pagave sepse grantin specifik e kan pasur me te vogel dhe nuk kan mundur mi mbulu vet planifikimin ne kategorin e pagave edhe nje pjes edhe 100.000 jan planifikuar ne shendetesi te kapitalet ndersa grantit specifik te arsimit ne kategorin e pagave I kemi ndihmuar nga granti I pergjithshem 295.000 afer 300.000 edhe ne kapitale 75.000 per me jau mbulu tenderin I cili është kete vit ka perfunduar mirpo nuk e di a është shpallur fitusi per renovimin e disa shkollave sepse ka shkuar ne ankesa, te vitet tjera per vitin 2027 buxheti I komunes se Deçanit do te jet, ose parashihet te jet 14.413.972 ndersa per vitin 2028, 15.126.162 dy vitet e tjera siq e dini jan edhe parashikim munden me ndyrshu per shkak te regjistrimit te popullsis ndoshta vitin tjeter ministria merr vendim me shku fiks si është numri I popullsis dhe me pas buxhetin me te vogel un po I listoj disa nga projektet kapitale te reja te cilat fillojn ne vitin e ardhshem per implementim ose do te fillojn procedurat e tenderimit. Kompleksi memorial per gjith deshmoret e kombit te komunes se Deçanit, ndertimi I kanalizimit ne fshatrat e Deçanit perfshir Gramaqel Baballoq (...) si faze e par ndersa faz e dyt do te jet pjesa tjeter e fshatrav te cilat nuk kan kanalizim zgjerimi I ndriqimit public efikas neper fshatrat (...) dhe rrugicat e mbetura ne fshatrat e tjera te Deçanit kjo është faza e dyt e projektit te cilit veq e kemi ne perfundim, ndertimi dhe asfaltimi I rruges (...) faza e dyt renovimi I shkollave qysh e ceka I cili ka filluar kete vit mirpo, kemi menduar me fillu por është ne OSHP dhe nuk e di kete vit a mundemi me I nis punimet pasi tash është edhe periodha e dimrit, ndertimi I sheshit te qytetit ndertimi I objekteve memorial deshmoreve te kombit ne fshatrat Lluk e Epërme Dranoc, Kodrali,(....), Memoriali I deshmoreve ne bjeshken e Belegut ndertimi I kanalizimit (...) ky është vazhdim bashk financim me CDF dhe fondet IPA jan per produktet

tursitike te cilat kemi apliku ne fondet IPA dhe kemi fituar nje shum afer 300.000 euro dhe obligohemi edhe ne me pas nje financim, nje pjes te financimit qysh e kemi parapar ne buxhet per 3 vite tretoaret ne Isnig, (.....), ndertimi I rreth rrotullimit dhe fshatit Gramaqel kanalizimi afer shetitores te lumit Lumbardh te Deçanit dhe lagjeve te tjera te qytetit te Deçanit renovimi I kulmit qe te QKMF-s ndertimi I ures ne Vranoc te vogel dhe Rastavic si dhe rregullimi I shtratit te lumit Baballoq ky është projekt I këtij viti mirpo per shkak te ankesave qe kan qen nuk e di a ka mundurt mu shpall fitusi apo është ende ne ankesa e kam parapa qe me qen edhe ne vitin tjeter ndertimi I bibliotekes muze ne fshatin Carabreg është projekt qe e kemi planifikuar është votuar vitin e kaluar por qe nuk kemi mundur mi nis procedurat renovimi I shtepis se cultures (....) restaurimi I shtepis se cultures dhe rregullimi I parkut te fshatit ne (...) edhe ky është projekt I vitit te kaluar qe është dasht me bart kete vit ndertimi I objektit te ri te komunes elektrofikimi I bjeshkes se Strellsit ndertimi dhe asfaltimi I rruges Mehmet Uka ne Deçan ndertimi dhe zgjerimi I rruges (..) dhe (..), ndertimi I kendit te lojrave per femij ne fshatrat Isnig Rastavic Dranoc (...) ndertimi dhe rregullimi I rruges dhe trotuarit ne rrugen e UCK-s ndertimi I urave (...) ndertimi I objektit per nevojat e OVL-s.

Per buxhet une kaq kam nese ju keni pyetje shtes është edhe kryetari qe mundet me u pergjigj edhe un edhe nese me lejohet kryesues dashta me ju pergjigj Albases per te cilen ne e kemi pasur nje degjim buxhetor per komunitete ekstra mirpo qe nuk kemi marr pjes asesi, edhe pse un kam ardhur ne takim kam ardhur 10 minuta me vones mirpo un nevojat e tyre I kom pas edhe prej takimit qe është mbajtur para edhe I kemi shtir ne buxhet ato sa kemi mrri faleminderit.

Hajdar Sutaj

Drejtoresh, faleminderit shumë. Edhe pse unë e pata ni kërkesë që ky pikë me e diskutu veçantë, por megjithate kolegia ka te drejt ju ka permendur emri me pas 1 minut replik, ju keni mirkuptimin mes veti me lene me diskutu ne fund kishte me qen me mir qe me diskutu qeshtjen e buxhetit a jeni dakord, faleminderit shum per mirkuptim ne emer te grupit te Aleances shefi I grupit Arian Dobraj e ka fjalen

Arian Dobraj

Faleminderit Kryesues i nderuar Kryetar Ramosaj, të nderuar drejtoret e drejtorive, të nderuar koleg dhe kolege asamblistë, po ashtu të pranishem përfaqësues nga OBSE-ja Në emër të grupit të Kuvendit nga radhët e Aak-s, buxhetin kesaj radhe edhe si herët tjera, e shohim shum ma gjithpërfshirës, se cilin e vlerësojmë me notë maksimale për shkak të përfshirjes se projekteve më të rëndësishme të mundshme që zhvillojnë edhe më tutje komunën tonë me fshatrat në rrethinë. I ceki edhe drejtoresha, po kisha dashtë me i ripërsërit për shkak se janë shumë me rëndësi me i përsërit që me na degju edhe qytetar. Njoni prej projekteve më të rëndësishme që e shohim për vitet e vazhdueshme janë ndërtimi i kanalizimit ne disa fshatra të komunës së Deçanit, te cili i përmend dhe drejtoresha. Pastaj loti katër, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës nëpër fshatra, te cilat po mendoj se përbën edhe ciklin e përfundimit të asfaltimit të infrastrukturës rrugore nëpër fshatrat e Deçanit, sepse nuk e di nëse do të mbetë ne vitin 2026 ndonjë meter asfalt pa ushtru ose ndonjë rrugë eventuale në komunën e Deçanit. Disa nga projektet e tjera që i shohim si shumë të rëndësishme ndërtimit të qendrës turistike, që është bashkëfinancimi me IPAN dhe GIZ, po ashtu edhe bashkëpunim me BEIN, Zgjerimi i ndërtimit publik efikas nëpër disa fshatra të komunës së Deçanit, Kolonia Artistëve, ndërtimi kanaleve të ujitjes në Deçan, Sarabreg, Belek, Kodrali, Isnig, që përbën, po ashtu një prej projekteve më të rëndësishëm dhe më vitale për banorët e këtyre fshatrave. Pastaj trotuari nëpër fshatra të(...), Prapaqan dhe Lluka e Epërme. Ëh, ndërtimi i rrethrotullimit trotuarin në fshatin Gramaxhel, si dhe shumë projekte tjera që përbëjnë një ndryshim shumë pozitiv për jetën e qytetarëve të komunës së Deçanit. E falënderoj kryetarin Ramosaj dhe drejtoreshën në përgjithësi Drejtorin e Financave për këtë radhitje shumë gjëpërfshirëse edhe domethënëse për zhvillimin më të tutjeshëm infrastrukturor dhe ekonomik të komunës sonë. Faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit zoteri Dobraj, në emër të grupit të Ldk-së, Albesa Cacaj e ka fjalën.

Albesa Cacaj

Pershendetje në emër të grupit parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, du me bë t'njohur për gjithë qytetarët e Deçanit se projektbuxheti i paraparë për 2026 80% janë projektet e përsëritura nga 2023 ka dhe projekte që janë përsëritura edhe nga viti 2021 domethënë, siç tha drejtoresha, janë projekte të reja kjo nuk qëndron në gjithë projektet 45-46 sa ishin 37 janë projekte të përsëritura pra vit pas viti nëse më lejohet, dua mi theksu me ta rikujtu ty, kryesuese, na cilësinë e shefes grupi i kom shtatë minuta faleminderit Kompleksi memorial për gjithë dashmorët e Deçanit është projekt nga 2023. Elektrifikimi i Bjeshkëve Belegut nga 2023, i kom nxjerr edhe shifrat ëh, pra parët sa janë ndarë ndër vite për këto projekte për shembull, për kompleksin memorial për gjithë dashmorët e Deçanit në vitin 2024 janë ndar 175.339 euro, pastaj në 2025 100 mijë, 2026 më s'planifikon 100 mijë. Pra janë projekte në vazhdimësi, po nuk pi përmendi shifrat për mos me marr kohë, veç projekte.

Ndërtimi i rrethojave dhe rregullimi i hapësirave brenda oborrëve të qendres rinore, projekti i përsëritur, ndërtimi i fshatit turistik Podi i Gështenjes nga 2023 ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në Pleqe, po ashtu 2023 ndërtimi i Qendrës Turistike nga viti 2024 ndërtimi i shtëpisë Alpine është projekt nga 2023 qdo vit tu nda mjete.

Zgjerimi i ndriçimit eficient publik nëpër fshatrat Papeq, Mazinik, Dashinac, po ashtu nga viti 2023 kolonia e artistëve nga viti 2024 ndërtimi i kanaleve të ujitjes në Deçan, Carabreg, Beleg, Kodrali, lezniq nga viti 2023 Rinovimi i shkollave në Voksh, Pobergj, Kodrali, Prelep nga viti 2023 Ndërtimi i objektit të ri të shtëpisë rezidenciale nga 2025 Ndërtimi dhe zgjerimi i rrugës së qendrës së qytetit nga viti 2023 Ndërtimi i sheshit qytetit nga viti 2023 Ndërtimi i aneks objektit për Zjarrfikës, 2023 blerja e veturave zyrtare e kemi 2025 60.000 euro, 2026 50.000 euro.

Memoriali në Bjeshket e Belegut nga 2023, ndërtimi i objektit memorial të dashmorve Lluke Eperme, Drënoc, Kodrali, Prapaqan po ashtu nga viti 2023, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës për në Bjeshket e madhe 2023 ndërtimi i kanalizimit në rrugën Elenagjika është nga viti 2024 elektrifikimi i Bjeshkës së Madhe është nga, ëh, nga viti 2025-2026, trotuari në Prapaqan nga viti 2025 ndërtimi i ures në Vranoc nga 2025, elektrifikimi i Bjeshkes në Strells 2025 ndërtimi dhe zgjerimi i rrugës Elez Geci nga 2025 që vazhdon 2026 Ndërtimi i ziplini nga 2025 ndërtimi i objektit komunës edhe kjo nuk shohim në rezultat, përveç që e shohim kodin edhe projektin, po kurrë punë të kryme.

Restaurimi i Shtëpisë së Kulturës rregullimi i parkut në fshatin Loqan është ndarë nga viti 2024 ndërtimi i bibliotekës dhe muzeut të fshatit Carabreg I Eperm nga 2025 po çka me ka len përshtypjen në kete projekt buxhet që u kan i përsëritur vit pas viti, po n'ket projekt në projektion 2026 nuk e kishin fut, është stacioni i autobusëve që kurrë nuk more epilog. Pastaj ndërtimi i deponisë për mbeturinat inerte, ndërtimi i objektit për mbeturinat e vëllemshme, që është nga 2023 tu përsërit si, si projekt, si investim. Trotuari në fshatin Irznik dhe Luke Eperme ndërtimi i paqem qytet, dorën zemër, një park aty të banesat sociale që nuk mund ti thuhet as park, kanalizimi, unë nuk e di a ka përfundu kanalizimi që e keni hek krejt ndërtimi i diges së ujit në fshatin Ratish. Ndërtimi dhe renovimi i rezervave të ujit për 10 fshatra dhe ndërtimi i varrezav të qytetit pra si përfundim, ne si grup parlamentar Ldk jemi kunder këtij projektioni të buxhetit për vitin 2026 duke argumentuar faktin si i potencova më lart, po edhe duke argumentuar faktin se nuk janë marre parasysh nevojat primare qytetarëve që jetojnë këtu e që përballojnë me mungesë kanalizimit të ujit, trotuareve, çerdheve, për me bo një jetë sa ma dinjitetshme nuk jemi kundër zhvillimit të Deçanit, sepse kryetari vazhdimisht e potencon kur nuk, kur ne asnjëherë s'ia votojmë buxhetin, po jemi për një jetë dinjitetshme me bo, me paret dhe taksa tona faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit, nga Vetvendosja Faton Selmanaj e ka fjalën.

Faton Selmanaj

Përshëndetje për te gjithë edhe ky projekt, si edhe në vitet para prakë, ëhë, është thuajse i përsëritur, ma shumë se 80 përqind ka projekte që ishte dashur me i prioritzu e që s'jon bë, siç janë për shembull projektet për Bieshken e Madhe në vazhdimësi që s'po nalin, siç është puna e elektrifikimit ka fshatrat tona, ka fshatra të thella në komunën tonë që janë Masniku dhe Atishë që s'kanë ndriçim publik, ndërsa elektrifikimi dhe infrastruktura në Bjeshken e Madhe s'po nalen Përveç kësaj, thashë që edhe jemi nfushat, ëhë, esht bo hala ma aktuale problematika me ujë të pijes nuk esht asnjë projekt i ujit të pijes në këtë projekt buxhet është shumë gabim ndërsa sa i përket projektet e kanalizimit të ujrave të zeza, ky projekt tash e 16-17 vite po shkon tu përsërit gjë që për mua ky projekt nuk përbën asgjë tjetër përveç një projekt mashtrimi dhe... fushate faleminderit kryesues nuk po e zgjat më shumë.

Hajdar Sutaj

Falemnderit po ashtu, zotëri Mon Selmanaj ka fjalën.

Mon Selmanaj

Faleminderit kryesues të nderuar koleg në diskutimin tim rreth këtij projektbuxhetit do të përpiqem të jem i qartë dhe i argumentueshëm për projektet me fjalë fillimisht do ndalim tëndaret buxhetore sipas kategorive ekonomike, ku në tabelat një, dy dhe tre na paraqitet struktura e shpenzimeve për këto vite. Nëse e krahasojmë këto shpenzime sipas viteve, na del që në vitin 20-.. të shpenzimet komunale kemi një rritje të shpenzimeve norme prej 800.000 eurove, që i bie 500.000 euro më shumë se vitet 2026-2027 andaj kërkoj nga ju, zoti Kryetar, të na sqaroni këtë rritje të shpenzimeve komunale. Te investimet kapitale kemi rënie drastike në vitin 2026-2027 nga 3.5 milionë të parapara për 2026 me 3 milionë në vitin 2028 edhe pse për këtë vit kemi një ngritje të lehtë të buxhetit. Në anën tjetër kemi rënie të investimeve kapitale. Nëse shikojmë shifrat e planifikuara edhe për vitet vijim janë pothuajse të njëjtat, pa kurrfar alternative zhvillimore. Në anën tjetër është përkeqarje që mjete që po planifikohen nuk po shpenzojnë ashtu qysh kërkojnë rregullat financiare dhe ligjet ne fuqi. Këtë e ka dëshmuar më së miri zyra e Auditorit përgjithshëm përmes raporte të auditimit, që për vite me radhë ka dhënë opinion të kualifikuar. Të nderuar koleg, në tabelën e ofruar me mërtimet projekte për investime kapitale, vrehet prap një orientim I nje anshem i projekteve shumë fshatra përfitojnë me shumë projekte, për shembull me kanale te uitjes shumë nga këto projekte po investohen në to e nuk e kemi ende një përfundim të tyre disa prej tyre janë siç u parafol si të potencuar fshati turistik Poddi i Gishtenjes, shtëpia Alpine bjeshkatore, rruga për Bjeshken e Madhe, përpleshe e shumë tjera. Tani pak du me u bo pak lokaliste ju kërkoj falje për këtë po jom i detyruar edhe për të ardhur keshtu në këtë listë me emërtimet projekteve është hequr nga planifikimi i projektit trotuari i-- në fshatin Rastovic projekt ky i realizuar nga kolegu im këtu me zyrën e tij projektuese, me përmasa dhe parallogari i vetmi projekt që është votuar në këtë Kuvend dhe ka hyrë në buxhet, që për tri vjet është bart buxhet pas buxheti. Si ka mundësi që të realizohen disa projekte tjera në fshatra të ndryshëm para tij e disa te tjera të, të planifikohen për vitet vijim? E projekti i gatshëm tre vjet i votuar më parë, të hiqet nga lista e projekteve kjo nuk do koment po i potencoj disa nga projektet të para para për këto vite. Trotuari në Irlznic, Prapaçan, Lukë e Eprëm e Gramaqel dhe rrugën Uçk-ës unë nuk jam kundër këtyre trotuarëve dhe këtyre aty, mirëpo të hiqet-- të hiqet një projekt i gatshëm i votuar këta nuk kam mujt me i kuptu hiq, absolut. Tjetër u përmend që në vitet në vazhdim do të jetë kendi I lojërave dhe ura në fshatin Rastovic ju jeni deshmitar që 25 vjet një metër kanal I ujitjes në këtë fshat nuk u bo patem shum rrugica e tjera ne fshatra te caktume do te asfaltohen dhe do te kryhen është I vetmi fshat qe është I lokalizuar me fshatrat tjera qe jan kryer keto pune ndersa këtu nuk figuron as per 3 vite e ardheshme qe keto rrugica ne kete fshat te shtrohen njeher e pergjithmon mua si inisus I këtij projekti nuk me dhemb aq shum mos realizimi I tij sa me dhemb shum shpresa e njerzve qe ende besojn ne drejtesi njeri prej tyre jam edhe un faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit zotëri Mon, kryetari Bashkim Ramosaj e ka fjalën dhe pastaj vazhdojmë nëse ka dikush tjetër, kryetar fjala për ju.

Bashkim Ramosaj

Faleminderit kryesues përshëndetje për gjithë juve të pranishëm, kolegë të Asamblees Komunale, përfaqesues të OSBE dhe kolegët prej ekzekutivit.

Unë... po dua ndoshta me me thënë diçka që është e zakonshme në seancat e fundit, në këtë përballje me disa asambleist sepse po shkojmë drejt po hym në një fazë tjetër, ku Asambleja me siguri do të ketë me pas në përballje prej vetë faktit që në pjesë këtu nuk kanë nuk janë konkurrent më. Po munohem të jem tepër konciz në ato që e thamë ne... unë jom tepër i përmbushur me vendimet që janë marë në këtë Asamble dhe me punët e mira që janë bërë në raport me dy-tre gjana po duhet të më mbaron kohë shumë. E kemi pas ne aktivitet tepër ngjeshëm dhe në ekspertizë tepër të madhe në pjesë që kanë punuar në këtë dokument edhe e dinë, edhe kemi arrit që në 2023 me pas ligjin e planit hapsinor të Parkut Kombëtar, i cili ka qenë lajmi ma i mirë ne jetën time prej jam në politik për shkak se kemi punu shumë dhe kemi marrë një pjesë vendimeve kohë ma përpara e që me u integru interes i qytetarëve të komunës së Deçanit, në këtë rast, brenda Parkut Kombëtar edhe kjo punë osht bërë falë vendimeve që janë marë në Asamblejën Paraprake, ku ne kemi shpall prona me interes për komunën, diku në më shumë se 750 hektar tokë në 14 parcela që na u kan pranuar, edhe ju kanë dedikuar planet e zhvillimor edhe komunale, ç'është lajmi i dytë më i mirë, për shkak se në kohë tepër të gjatë na ka dasht me rezist për dy gjana të vetme. Hapësira administrative e komunës Deçanit nuk ka pranuar si marrës, Institutit të Planifikimit Hapsinor edhe politikave, e që ky instituti përpunon si zonë ndërtimi, sidomos për pjesën që fillon prej zallit Strelcit dhe deri te ura Dimes, e po ashtu prej Agonisë së gaz ose prej Bonarit të fushes, që thojmë ne, e deri në Baballë dhe kemi arrit mrekullisht me rezist n'këtë temë që me, me pas në koncept ashtu sikur e kemi ndertu vet dhe njëkohësisht brenda këtij plani zhvillimor janë edhe këto, këto parcela. E kam kërkuar që brenda këtij projekti buxhetor me qenë spaku e pesë prej tyre, ku ne bejm plan rregullues detal qofte për bishkën e Belegut, qofte për, uh, Livadhin e Mërgelkës e lakun e kryq, qofte për Dervish Komin, qofte për Shkurzinë, qofte për fshatin Alpin ose që jemi mesu me I than Shkëlzen Haradinajn në Baballë domethan këtu dy gjana janë tepër të rëndësishme për jetën e qytetarëve të Deçanit dhe për krenarinë e krejt neve që jemi në këtë sall, që kemi bërë në punë tepër të madhe për me shku deri këtu. Ajo që ka ndodh në aspektin e infrastrukturës edhe në raportin sektorial, po ashtu jom tepër ndina i përmbushur me ato që kemi bërë nuk jam idhtar fort për vendbanimet me emra, për shkak se sa herë që po votohet ky buxhet, na dalin me thojmë nuk ishte ky fshat fshat, ishte ky fshat, edhe osht krejt normale, sepse na vijnë prej dika. E obligimi i krejt neve është me ju dediku territoret administrativ të komunës Deçanit dhe kjo ka ndodh ka ndodh sepse e kemi pas ne në- në patë dhe për me qen tepër i sinqertë unë du me falënderu vetem një njeri në këtë rast, që osht Ministër i Infrastrukturës, zotin Durmishi, që ka pasur si mirëkuptim në këtë raport. Nuk e di unë unë ja kam borxh një falënderim publik, për shkak që na ka mirëkuptu nuk është problem.

Jemi ka punojmë në 14 fshatra sot, 14 fshatra të cilat nuk janë përmend në buxhetin e vitit të kaluar, nuk kanë qenë projekte. Mirpo jemi ka punojmë dhe kemi punu në krejt vendbanimet derisa, deri sa harxhohet kjo kontratë ajo që është e lojmi që nuk, nuk e kemi thonë publikisht, jemi në fazën e fundit e të diskutimeve me në ekspertizë tepër të madhe e... në raport me Bankën Botërore, që osht një buxhet më i lart se sa njëqind miliona euro, që ka me trajtu çështjen e ujërave zeza në tërë territorin e komunës Deçanit.

I kemi dy projekte, që njëri përfshin dy Strelcet, Lebushen, Isniqin, Dubovikun, Prapaqanin, Boriqin, Papiqin dhe inpiantin në Boliq e projekt që jo është themeluar 2021 projekti i cili ka shenë i nevojshëm edhe po ashtu, projekti që i dytë që mrena në vendimi është largu nga buxheti, që është i viti 2021 po ashtu, që është regjioni i Vokshit dhe i inpianti në Shaptej, duke trajtu pjesën e fshatrave që kanë probleme me

ujrat, eh, që janë afër sipërfaqes, duke l perfshtir prej Prelepit, Prokollukun, Jerzniqin, eh, pjesen e Shaptej, të Gloxhanit po ashtu, Dubraven dhe pjesen e Gramaçelit e për këtë unë jam mirënjohës. Në ndërkohë po du me spjegu edhe diçka qdo projekt buxhetor që është aprovu n'këtë Asamble komunale nuk është se unë kam thonë që s'e keni votu buxhetin kurr ne jetentime kam thonë ni ditë në televizion për shkak se dikush e ngriti ni, ni të pavërtetë dhe për hir të së vërtetës, mua m'u dasht më thonë që s'kanë votu buxhet. Mos m'u burrë ni prej ketij teme që s'keni votu buxhet kurrë. As mos e thoni! Për shkak se ne jemi përgjegjës me votu jem përgjegjës me propozu me thonë: "hekmani kete shtini kete", esht më interesue kjo me argumentu, po jo gjithmonë paraprakisht me bo tradicionale mosvotimin e buxhetit. Pse përsëriten buxhetet? Të gjithë ne duhet me e pranue, ni fakt. Komunitat e Republikës së Kosovës, jo vetëm Komuna e Deçanit, i ka goditë ni veprim skandaloz, i cili ka t'bojë me kontratën kolektive as ni projekcion buxhetor, l ndonje organizate buxhetorit që quhet Komunë, nuk mundet me u realizu për shkak qëti defekti, qëti absurditeti, ç'e ka ndodh k'ti shteti e këtyre komunave dhe unë besoj, unë besoj që na nuk duhet me hekë dor prej disa gjanav, asnjëherë. Ne këtë dokument, ne këtë projekt buxhet, ketij viti që, implementohet për vitin 2026, nuk kisha pasë ndoshta naj... dëshirë me u fol për vendbanimet te veqanta mirëpo për tek saj naj me dy tri raste, edhe munen me u thonë. Munen me u thonë keto katër objekte shkollore që janë met me nje standat ma te vogël, po s'janë tepër të nevojshme, që mi interveneru ne to dhe me be njejar harmonizimi spaku në aspektin e, e akomodimit të nxënësve, mësimlexëve edhe njerëzve që funksionojnë në ato shkolla. Dhe kjo lihet. E kur po flitet për, eh, Loçanin për Serrabregun e Perëm, ju e dinë që ne kemi pasë ni aktivitet et buxhetimit... me votim drejt për drejt. Edhe ka qenë ni eksperiment te e ka bo ni organizatë ndërkombëtare që ka ardhë ketu dhe ne e kemi pasë ni ide, hajde ta provojmë si pilot projekt, cili osht ai dhe kemi zgjedh dy vendbanime: Loçanin edhe Carrabregun e Epërm dhe ka kalu mirëpo si institucion, si mekanizëm buxhetor ndërkombëtar, osht shumë me ni vendim et ni... president i vëllaut. Që e udheheq shtetin me te madh dhe tash na nuk e mujt me mos me pas buxhet spaku pjesën tonë, sepse s'ka pas me me qenë llogari krejt e jona ajo që, e mora fjalën për me sqaru, në rast se kemi mar vendime 2018-2021, ketyre vendimeve ju kemi ndejt shum gati kemi bo shum ekspertizë, që me kalu ne dy dokumentet që janë tepër të rëndësishme, që është Ligji i Planit hapsinor dhe që është Plani Zhvillimor e që së fundmi është edhe Harta zonale. A duhet me fol për rrymë, që ka me shku ne keto tema? Po. A duhet me u nal mos me qu rrym Bjeshk të Madhe ose në Bjeshk Belegut? Jo, kurrë s'duhet me u nal. A duhet... Me hek dor prej asfaltimit për Bieshken e Madhe ose për (...) kurrë s'duhet me u nal, a duhet me e dërgu rrymen e Bieshken Strelcit? Po, por kurrë s'duhet me u nal dhe a duhet që to vendbanimet që janë nalt e që to oaza që i kem bo zhvillimor, që po dojnë me thy ni koncept idioresk dikujt me pas edhe ujesjellspo, a duhet me bo diçka për ambientin, sepse krejt këta ujë është, nuk janë habitatin e vet, esht ngypat e stane-tana që i kem ndërto, edhe është nje ide krejt tjetër uroj që Asambleja e ardhshme me pas për nderin e vet, që me e aprovu planin rregullues detal të këtyre parcelave që dikur ke marrë vendim dhe kem ra në kundërshtim me krejt ligjet dhe me krejt normat që dikush i ka lan. Unë ju sugjeroj që me kon pjesë, e votimit te keti buxheti për shkak se e vlerësoj që është buxhet zhvillimor i kësaj komune dhe është standard i ri që po krijohet në këtë qytet me shum mund, a duhet me pas kompleks memorial? Në komunën Deçane ku përfshihen krejt dëshmorët e kombit? Po duhet me pas, a duhet me pas aksesor tjerë, që këtë kompleks memorial nuk e bojnë vetëm për historinë mos e keqkuptoni këtë temë vetëm për kulturën. Mirëpo, që jepin zgjidhje, shtrohet në një epiqendër edhe të turizmit për shkak se njerëz që shkojnë aty duhet me pas disa shërbime, a kanë bibliotekë? A kanë një kandë te lojrave? A kanë atraksione tjera sportive edukative? Po duhet me pas, a duhet me pas naj, naj dyqan aty që, e jep naj souvenir të ketij vendi ose kësaj historie tonë? Po duhet me pas, a duhet me e marrë model një komunë tjetër që e ka përmbyllë këtë far pjese? Po dhe... të lapidarët... jom teper, po ashtu edhe l kenaqur qe na kanë metë... tri-katër fshatra, po... pa keto memorjale ndoshta nesër, masneser dikush ka me thonë... Jeni ngut, s'jeni ngut. Jemi ngut me, me Qendrën e Deçanit, kemi bo improvizim nuk është koha e improvizimit më kemi ndarë gjithmonë buxhet projekti është 22 milion euro është projekti ma i mirë që dikush e ka hartuar ne Republikën e Kosovës, a duhet... me u hek që ky pallat për shkak se ka një simbolik që s'duhet me pas? A duhet me kon e hekne komuna, gjykata, ajo... e regjistrat civilil po duhet me kon, aduhet me kon Mullini i zhvendosun? Po, duhet me kon, dhe ka me kon. Dhe a duhet me kon ni vend ku... janë... dëshmorët... në ni... në ni pllakë, ku e vendosin veq nje lule kjo

është koncepti, kjo është ideja edhe ketu tema unë nuk nalna pa i thënë përditë e sa here që më jepet mundësia faleminderit.

Hajdar Sutaj

Kryetar, falimnderit shumë më falni nëse kam mundësi me... përcjell rradhën Faton Selmanaj si anëtar i Kuvendit, Vatan Istrefa, Florim Mataj, pastaj Albesa, Blenera Syla e kështu po shkoj duke i shkruar fjalën e ka Fatoni e ka Vatani pastaj Florimi

Faton Selmanaj

Faleminderit, kryesues po kryetari e ceki qe mos me u lëshu në emra por nuk mundemi pa u lëshuar në emra, sepse është fakt qe është brenda teritorit por jasht kompetencave, jasht kompetencave te tua sepse është brenda parkut nacional projektet qe I ke quar ne bjeshken tende dhe brenda dëshirës tënde, nuk thash që nuk duhet me shku projekti atje kryetar por duhet me I prioritetizoj, nuk ka gjë më të dhimbshme se me shku në (...) natën edhe me u frikësu nga terri që është aty, në secilin fshat ke quar ndriqim publik ne shumë prej tyre edhe trotuare njëjtë edhe në (...)është gjendja, mos na u kap për fjale tash që jemi kundër investimeve per bjeshk ku e kam te qart qe e ke fokus turismin është krejt në rregull që me u zhvillu edhe turismi në komunën tonë por qeshtja është qe proretizoj projektet kaq.

Hajdar Sutaj

Po kryetari Bashkim Ramosaj e ka fjalën.

Bashkim Ramosaj

Un... ju falenderova për... disa tema që kemi pasur të përbashkëta e thom me krejt përgjegjësi, që as një komunë, në Republikën e Kosovës, nuk ka marrë investime më shumë prej Kedsit me trajtimin e komplet të rrjetit elektrik dhe po ashtu, jemi të 20% që na kanë marrë pa përfundu ndriqimit eficient në këto vendbanima pra ata duhet me kon pjesë në projekt vazhdim e tu kisha lutë jo ty krejt njerëzve të këtij qyteti asnjëherë mos me hek dorë prej kesaj ides sepse është bë shumë mundim është bë shumë e shumë ekspertizë edhe është shpënzuar shumë kohë për me ardh deri në këtë pikë nuk keni më nit u fol per turizëm ndonjeher nuk keni me më ndi per shkak se un mendoj se jemi kriju si gjenerat te kesaj ideje te keti koncepti nuk ka qenë ky concept më herët nuk ka mundur me egzistu per shkak se ne 2012 është miratuar ky ligjë I parkut kombetar krejt ideja është qysh me qbo këtë dhe ne e kemi qbë jam shum me fat që I kam pasur disa kolegë që kanë arrit me qbë këtë me I nderlidh interesat e qytetarëve të Deçanit me këtë pjesë dhe kjo është teper e rëndësishme per te gjithë ne që jetojm këtu faleminderit.

Hajdar Sutaj

Kryetar, faleminderit. Vatan Istrefaj e ka fjalën edhe mos të harrojmë që zotri Mon Selmanaj e ka pasur një pyetje në lidhje me një projekt në fshatin Restovic ndoshta drejtoresha duhet me u pergjigj. Kryetari, një përgjigje ndaj zotris Mon Selmanaj

Bashkim Ramosaj

Kerkoj falje Vatan, e kështu... sa i përket Restovices... po e thom Mon ndonje her nuk te bin krejt te mirat hise.

E dim, e dim që ne në çdo vendbanim nuk i kemi kry krejt punë mirpo, jemi mundu me bo një far bilanci, para zhvillimit harmonizim krejt vendbanimet tona e me vjen keq është projekti i parë... I ketij viti që osht tenderru ka qenë... Ura Vranosit dhe Ura Restovices edhe paramendo na jemi në muajin ne fund të shkatorit... edhe nënshkruat kontrata... mm këtu ditë, për shkak të dy kompanive që kanë, kanë hy në gjykatën e tenderave me vjen keq për kete pjesë ajo që... po ashtu osht... e rëndësishme për mu, për ty, për kete Asamble... e kur kemi than që... një pjese e buxhetit duhet me projektu si formë joshje për mekanizma... buxhetor, t'niveli qendror edhe ndërkombëtar e ja kemi arrit ni qëllim, sepse tri vjet në kod buxhetor ne kemi lon... Lumin, ose Lumbardhin e Loçanit... me fillu prej Jasiqit dhe me përfundu te Hulaj dhe jam tepër i lumtur që jemi në fazën e fundit si lajm i mirë është që ky projekt po ecë, edhe pritet që me fillu sa shpejti. A shkojnë dy vjet, a shkojnë tre vjet, unë nuk jam i mundur që mundeni ju besoj procesit. Edhe po ashtu te ka nalet të ujitjes kemi punu me këtë kontratë ndonjë fshatra që kanë pasë, si masvlerësimi tim, e kanë pasë ma shumë nevojë. Po dasht me thënë se tjerët s'kanë nevojë, po çaktuar ndër prioritete ka radhëja që lon, ka radhëja që s'lon. Dhe këto trotuaret, nuk e di pse bëjnë për vende në shtet, por trotuaret janë për krejt e vendbanimet e sidomos për vendbanimet ku ka shkolla, sepse hyjnë në këtë, eh fushën e sigurisë, eh për shkollat kaq kerkoj falje që nderhyva

Hajdar Sutaj

Më falë se në atë ka me u pergjigjë drejtoresha në fund, Vatan Istrefaj e ka fjalën, e pate një drejtoresha që e ka shkruar për shpenzimet për 500.000 euro rritje.

Vatan Istrefaj

Faleminderit për fjalën, kryesues edhe një herë përshëndetje për të gjithë, pasi që sot po diskutojmë për një, për projektin buxhetor të komunës së Deçanit, e cila është një nga dokumentet më të rëndësishme në komunën tonë, dhe që ne funksionojmë me të, po mendohej që të jem sa ma konstruktiv dhe të mos i persëris ato që thanë kolegët para prakë deri tani sot po diskutojmë për një buxhet rreth 14.500.000 euro prapë për vitin 2026 por ky buxhet nuk është buxhet i zhvillimit ketë e them me kompetencëtë lartë prapë për veten, pasi që është buxhet më shumë është buxhet i stagnimit po ashtu, kryetar nuk po na jep shpresë shumë ky buxhet, nuk po na gjallëron ekonominë, po ashtu edhe me këtë buxhet rininë nuk mundesh me majt këtu.

Është vetëm me mbajt gjall administratën, po ashtu edhe luksin e pushtetit pasi që shumica e projekteve kryetar këtu po janë të persëritura duke filluar, nga projekti për kulmin e QKMFS në Deçan që sa vite i persëritur. Po ashtu, kryetar e the se ne duhet folim pak me krenari, po nuk u di qysh mundem mefolur me krenari kur, përmbaruesi privat na i kemi këtu edhe si për shembull tek investimet kapitale. I ke ndarë rreth katër, rreth tre miliona e katëqind mijë euro investime kapitale e ti e din se shumica prej tyre si të fillon viti fiskal pra në janar të vitit 2026, kanë me terhek përmbarues privat.

Atëhere na trego kryetar që qfarë krenarie dhe si ki mi përfundu këto projekte po ndalem pak te bujqësia duke i parë projektet për bujqësi, e kom pa që janë vetëm dyqind mijë euro për fermat e Deçanit nëse e marrim një shembull shumë konkret prapë, bujqësia mundem me qenë arteria kryesore e zhvillimit në Deçan, dhe mund te marrim një shembull të thjeshtë një traktor për ta blerë kushton rreth katërdhjetë mijë euro - pesëdhjetë mijë euro. Atëhere shiko si çfarë ndihmesje mundesh me bo për fermat tonë po m'vjen keq qe nuk është drejtori i bujqësisë këtu po, ndoshta don fushatën do ka pak ndar sera anej multikultivator për fushat po ashtu uji dështim për qytetarët e Deçanit qështja e ujit është ... është një nga

problematikat kryesore që kemi ne Deçan kryetar, dhe po përballlemi çdo ditë me të pasi që shumica e fshatërve pra po thuajse në sezonin e verës dhe në vapën më të madhe nuk kanë furnizim as ni orë në ditë me ujë të pijshëm pra këtu siç kem llogaritur kryetar ne buxhet janë të parapara vetëm dyqind e pesëdhjetë mijë euro per kanalizime edhe ujësjellës. Po ashtu tek infrastruktura kryetarë, nuk do me thonë që të shohim vetëm asfalt, po tek kanalizimet me dyqind e pesëdhjetë mijë euro na tregoni çfarë mund te bojmë ne me to dhe drejtoresha e cekin me herët që do të ketë, investime në rrjetin e kanalizimeve ne Decan, po na trego a kemi projekt ne për këto drejtoreshë edhe kush e ka hartu. Po ashtu kryetar, i i përmende edhe planin rregullues për Parkun Nacional shumë mirë që e përmende por se pari a kemi ne Harta zonale në komunën tonë po e nisim nga poshtë, pastaj po shkojmë te kompetencat qendrore dhe kështu kryetar, ky buxhet nuk është buxhet i zhvillimit, por buxhet i lluksit po thuaj pak a shumë ti kisha jap disa propozime kryetar, si për shembull bujqësi nga 200.000 euro që i ke paraparë, vazhdo dhe rrite këta së pak në 1 milion vitin e fundit për ujësjellës të ujit te pijes, pasi që pak këtu nuk ka ujë dhe nuk mund të ekzistojmë. Plan strategjik për turizmin në investime madhore, gjithashtu edhe në infrastrukturë. Investime reale pranë infrastrukturën e shëndetësisë dhe jo përmbaruesi privat t'i marrë paret nga, nga këto projekte. Po ashtu, kryetarë qa është shumë bazike edhe është... shprehje morale e mirë, trajtim i barabartë për fshatrat e mëdha, si për shembull siq janë Strellsi Isniqi region i Vokshit e kështu me rradhë nuk mundesh me kon për ni fshat nën e per dikënd njerë kështu që kryetar, ky buxhet nuk e meriton votën time personalisht as grupit tim parlamentar, sepse nuk është buxhet i qytetarëve, por buxhet i pushtetit dhe interesat të ngushta këtu faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë kryetar, para se me marrë fjalën, deshta për me thanë që drejtori i bujqësisë sot nuk është këtu, grua e tij ka lindur sot, është bërë babe, i urojmë ishalla shëndet e gjitha të mirat me jetë të gjatë e ka edhe djalin, po kryetar urdhëro.

Bashkim Ramosaj

Faleminderit unë në 2018 veprimi i parë që është bërë, është ndërru një pjesë e normave të statutit komunes Deçanit për shkak se ideja... me blloku... buxhetin, votimin e buxhetit në atë kohë ka pasë edhe ni çasje tepër të madhe ligjore dhe në hartimin e këtij statuti, që duhet të votohet me dy tretat, e ka qenë ni normë që neve na ka qit gjithmon telashe kjo normë ka qenë e propozuar nga subjekti juaj politik dhe e mbrojtne për ni kohë tepër gjatë derisa u shëndrru kjo normë e para... I nenshtrum me subjekt tradicionalisht që nuk e votonin buxhetin dhe ajo që është më e rëndësishme për mu është me ta bo vetëm një lutje e bonu i sinqertë në ato që e thu dhe kur mos meno që munesh me manipuluar tu shfrytzu kamerat këtu, në ato që e thu për shkak se njerëzit e kuptojnë pak më ndryshe këtë situatë edhe kur një kryetar i subjektit tuaj politik përballet me sfidën e ujit pijes nuk është mirë ati me i bo komente që s'ka faj, e mu më thonë ki faj kupto drejtë që janë gjana që përcjellin dhe nuk, nuk i bojnë nder ndonje personaliteti i cili e ka qëllimin me u marrë me, me politik. Dhe kur flasim për përmbarim, osht mirë me e kuptu, në esencë, ç'është Kontrata kolektive dhe ç'është përmbarimi edhe kur flasim për Planin zhvillimor, kur flasim për hartin zonale, osht mirë me bo dallimin mes tyre edhe po ashtu me Planin rregullativ rregullues detal, e një zonë të caktuar, që osht... prapë së, prapë subjekti i miratimit nga ky institucion edhe nga institucionet që... janë te nivelit qendror në këtë radhë, Ministria e Ambientit edhe kur flasim për kanalizim, nuk pat ni minut, dy, tre minuta, pesë minuta përpara unë tregova që jemi në fazën përfundimtare, të përmbylljes te një investimi që përfshinë më shumë se 100 miliona euro, dhe jemi në fazën përfundimtare këtë po ta them me përgjegjësi me te lart që ka të bëjë me Bankën Botërore, sepse ky komunikim që unë e thom sot, e dëgjohej edhe prej aktereve qe jan te kyqur në këtë marrëveshje edhe nuk besoj që unë bile se paku jam... ai njëri nuk besoj as ni aj prej, prej jush këtu që ka naj... qëllim, në një fshat mi investojnë, në një fshat mos mi investu kete se kam par ende prej asambles as prej egzekutivit, nuk e kemi kete trajtim e urime per Rifatin

Hajdar Sutaj

Jo... I nderuam, po më vjen keq nuk ta ka permendur emrin a nuk... me fal mos te keqkuptohemi jan lajmruar plot që e kan fjalën edhe, edhe nuk është... po krejt rregull është, po ne s'e kemi mundësi kqyrë, kolegë, na me të vërtet jemi në prag të zgjedhjeve po nuk ka gajle na edhe përpara kemi bere kesi diskutimesh është kejt gjuhë normale kjo unë nuk e marr kështu po mos.. vetëm ta diskutojm Fal, ti I the fjalë tua, ky i tha fjalët e veta po vërtetë tash, na ke mujt mos mu pajtu me ty dikush me neve kështu shkon kjo Miftari pastaj Florimi. Miftar Ahmetxhekaj jeni krejt me ren besom i kam shkruar te gjithë, kerkoj falje.

Miftar Ahmetxhekaj

Faleminderit shumë kryesues me gjasë është seanca e fundit sa po mundem me kuptu dhe ishte dashur pak ta ruajm.

Kryetar jo për të dhanë sygjerrime, po nje prej parimeve të demokracisë është... mendimi i lire, mendimi i lirë deri aty ku nuk shkon në fyerje është e padrejt ndoshta me gjyku dikon se mendon më ndryshe por jo na mendojmë ndryshe është e drejtë e jona e pakontestushme mos ta mbështetim buxhetin per shkak se ne mendojm ndryshe ne nuk mendojm si ju është korrekte kjo bile nuk e di pse duhet te jet kjo kerkes shto kesaj se ne I kemi gjykimet tona per kete buxhet personalisht unë I kam gjykimet e mia, nuk pajtona me renditjen e projekteve qe I ke ne tabelen e investimeve kapitale qe ne hyje te këtij dokumenti verehet qart un personalisht me nje vleresim te drejt qe un mendoj qe kam te drejt është një disharmoni mes shpenzimeve kapitale dhe kategorive te tjera do te thotë janë ulur shpenzimet kapitale e dyta apsolut ka projekte të përsëritura ju nuk duhet me mohu kete ka projekte te perseritura dhe ka projekte jo serioze per te cilat un nuk e kuptoj te kolona 2 ju e keni parapa ndertim te kanalizimit ndersa vlere e këtij projekti është 500.000 euro unë e di që as ju nuk e besoni që me një shumë të till mund ta permbyllni një projekt ndersa ti paraprakisht e the qe është kostoja per 3 a 4 fashtra është milionshe e dyta ki projekt pershembull per shtrirje te rrugeve I ke 250.000-300.000 euro ndersa ti paraprakisht ke nenshkruar nje kontrat e cila ajo kontrat është 5 milion euro e 3-ta ke parapa nje projekt pershembull per Bjeshten e (...) e cila nese nuk gaboj ishte 200.000 euro ndersa (...) ne vitin 2019 e ke shpallur si vendbanim pse nuk e trajtoni si vendbanim sikur fshatrat tjera te jemi korrekt nuk mundesh me më bind ti mu me ta mbështët nje projekt buxhet per te cilin nuk pajtohem me këtë, ky kuvend ka aprovu parcella katastrale per ndarje per qerdhe per femijë, asnjeë qerdhe nuk e ke parapa ne 3 vitet e ardhëshme, unë e di qe duhet te jet prioritet turizmi.

Organizimet ne komuna perafersisht sikur ne familje nese ti nuk I vendos prioritet para lluksit është gabim per vleresimin tim dhe per shkak te ketyre parimeve ne nuk e mbështesim dhe nuk mundesh me na kerkuar nje gje te till, jo nuk e mbështesim faleminderit.

Hajdar Sutaj

Jo vetëm desha me thane që gjethkund ne botë aj që ofron buxhet dhe qeveri kryeministri I lut gjeth me votu, nuk është e keqe nese kerkohet votimi e juaj është me vlerësu atë kryetar fjala për ju.

Bashkim Ramosaj

Unë nuk është hera e parë qe ju ftoj për me përkrah këtë buxhet nuk është hera e pare sot e prej qe e mbaj veten n'mend, edhe si asambleist edhe si drejtor I administrates edhe si kryetar I kom lut njerez për me me aprovu me votu buxhetin përtej kësaj nuk mundesh djalin ose vajzën tane me shti mendu sikur ti. Me ty nuk e marr përsipër këtë pjesën që me te shty ty ose dikënd tjetër me mendu sikur unë. Unë

munohem të argumentoj ata që unë e thamë edhe ata që unë e di ajo që është e rëndësishme për mu është hapi 1 është hapi i parë, sepse s'mundesh me e bo kurrë dytin pa e pas guximin edhe pa e pas idenë me bo të parin. dhe unë mendoj që kështu ka funksionu deri tash kështu ka funksionu në raport me buxhetet komunale, jo vetëm me te komunes së Deçanit po edhe të komunave tjera, ku na duhet me i me i pas disa synime nuk kuader te ketyre synimeve unë nuk jam aq çmendur sa me mendu se (...) punohet me 200.000 euro as nuk mendoj se rruga per bjeshk te madhe perfundohet me 200.000 euro as kanalizimi me 250.000 euro mirpo jom dëshmitar edhe jeni dëshmitar e pranuat ose nuk e pranuat ne i kemi pasur vetëm 150.000 euro kur kem lidhur kontratë për 6.500.000 edhe është zbatu kjo kontratë është përfundu është pranu teknikisht. Kush ka fitu? Kemi fitu krejt ne e njëkohësisht ndoshta pa dashur me I permden me emra kemi me shum se 15 raste qe mundem me ti rendit një pas një që kështu kemi hyr dhe kemi dale te suksesshëm ne objektivat qe I kemi arritur andaj per mua nuk është e rëndësishme shumë sa buxhet ke e rendesishme per mua është me pas ekspertizen me I pas projektet te harmonizume dhe te pranushme qe me driten jeshile per me vazhdu dhe kostoje pastaj janë pjesë e cilkit buxhetor të mekanizmave institucional prej te cileve edhe nvaren bukur shumë ne kete po du me mirkuptu per shkak se e di qe edhe ti e din qe keshtu ka ndodhur.

Hajdar Sutaj

Kryetar Faleminderit shumë.. Florimi ka qenë Sylja, pastaj ka shum te lajmruar , ja kaloj fjalën Syles.. jo Syl fol ti .. a bën me I lexu emrat unë qe mos me më thane ...është Florimi është Sylja është Orgesi është Blinera është Albesa është Ariani dhe Leotrimi në rregull atëher Florim a po don me fol para Syles, Syl Balaj e ka fjalën.

Sylë Balaj

Atëherë, përshëndetje për gjithë pasi shumicën I ceken edhe kolegët, unë po bona pak lokaliste kryetar, se projekt buxheti i paraqitur për vitin 2026-2028, per Isnqi, Isnqi është prej fshatrav me te medhaja afer 5000 banor e keni parapar nje kend lojrash dhe nje renovim I vogel I shpis së kulturës na kem nevoj per degjitalizim ne shkollë tabela digjitale ka nevoj shkolla e Isnqit femijet tan mesojn ende si ne kohërat e 90-ta me nje shkums me nje shpuz ne dorë kemi nevoj per laboratore moderne jo per nje kend lojrash, femijet se pari duhet te mesojn pastaj te relaksohen se keni parapa prap per lagjen Osmanaj kerkes tash e 12 vite kryetar prap skeni parapa asgje, kalojm te bujqesia Vija e Gushatit ujiten mbi 100 hektar tokë tash e sa vite I bllokum, vija e Gështënjes ku ujiten Isnqi, Lëbusha dhe nje pjesë e Strellsit edhe ajo e bllokuar prapë...mungesa e qerdhes ne Isnqi besoj që është më prioritet se një kënd lojrash faleminderit

Hajdar Sutaj

Faleminderit, kryetari Bashkim Ramosaj e ka fjalën.

Bashkim Ramosaj

Faleminderit unë spo di as qysh me u shpjegu këto pjesë, e që këto kërkesa kanë ardhur prej komunitetit të fshatit të juaj, renovimi i shtëpisë Bërit Beker ka ardhë prej juve, ka qenë kërkesë edhe subjekteve politike edhe kryesisë së fshatit edhe aktivistëve që vinë prej atij lokaliteti është kështu deri tash, një kend i lojërave po ashtu ka ardhë prej aktivistëve të këtij fshat është kështu deri tash e standardet që janë krijuar në shkollë për ditë jan duke u permirësuar kohë pas kohë dhe ajo që kemi than për Behovcin për lagjen Osmonë edhe Mulaj, unë dje kam qenë në lagje e kom bo një fotografi, jemi taku bashkë, jemi përshëndet bashkë në ndërkohë, edhe po besoj që është punë që po perfundohet ja ka nisur te mulajt ka me shku deri te Osmanaj, sepse është ni, ni rrezik aty edhe ky rrezik më vjen mirë që po eliminohen tashti do gjana, do gjana janë edhe do gjana jon edhe, edhe process unë nuk jam pajtu me pas qerdhe mobile në Isnqi

sepse ke mujt me bo nuk, nuk jam pajtu në informatën çfare është sjell ajo qerdhe është ma mirë me bo diçka të qendrueshme sesa me bo diçka jashta, jashta standardi. I pergezoj ata mësimdhënës dhe drejtorin e shkollës, për atë që bëjnë në shkollë edhe në këtë rast unë, jom kon në ni aktivitet të organizum prej, eh, Drejtorisë së Hërrësimit, ku kom parë shumë njerëz të, atij, lokaliteti, lokaliteti që janë mes te asaj shkolle, e që i nimojnë, i nimojnë aj saj shkollë e nuk ka qenë tu bojn politik, sepse kur mbohet ty do subjekte politike tjera, aktivistat, partive politike, dhe nuk jom, nuk jemi fol për politik aty. Ka qenë një menuje. Po, po besoj që, po besoj që jemi, jemi në, në rregull me investimet e, e bo më nis nis. Ajo që jet objekti i janë është, përfundimi i Bellas, sepse kom pikë me përfundu Bella një herë. Me përfundu për shkak të rëndësisë që ka jo për ty e për mu, po ka rëndësi për, për at filozofinë e qenurit Deçenas. Jo, e Bella përplase jem në rregull, po Bella është ma, është pika por, është adresa por, llall që kemi thy llogjika.

Hajdar Sutaj

Kryetar faleminderit shumë e kuptoj Syl qe ke kërku fjalën po kanë kërku edhe tjerë, Orges Tafila, e ka kërku fjalën edhe mundesisht regjia me ja ndez mikrofonin

Orges Tafilaj

Faleminderit kryesues përshëndetje, përgjith fillimisht në lidhje me reagimet tona që keni, që kemi pas për shkak të debatëve fatkeqësisht nuk mundemi me ju ik për shkak se ka persona që... muajt e fundit vin Deçan edhe na akuzojnë komplet opozitën.

Tash a krenohemi pse kemi votu kundër buxhetit? Nuk ka të bëjë me krenarinë, po ka të bëjë me ni vizion ndryshe, qoftë individual, qoftë edhe të subjekteve politike, ndër ta që kam reagu kam qenë unë pse kam votu kundër disa herë? Ka qenë sepse kam mendu që projekte t'ndryshe që janë dal edhe nga dëgjimet publike me qytetar është dasht futën ne projeksionin buxhetor, tashmë me projeksionin e ri buxhetor pos një dëgjimi publik tjerë janë mundu me marë pjesë edhe shoh këtu që ni pjesë e tyre që kanë rrjedh nga këto dëgjime publike janë inkorporu edhe vlen ta cekem për shembull, ndërtimi i kendit t'lojërave ne kemi votu edhe në asamble, po është edhe ni kërkesë, sidomos se Bacit Mon edhe pjesës tjetër që është përmend shpesh ndertimi dhe zgjerimit të rrugës Elez Geci edhe Magjun Bërisha Yllarta nuk qenka po e ka përmend shpesh edhe normalisht e ka pas përkrahjen tonë ndertimi i objektit për nevoja të OVL-s po, pastaj pjesë tjetër, ndërtimi i urës (...) të vogel Rostovicë dhe rregullimi i shtratit të lumit Babaloç jon më se të nevojshme edhe osht diçka kërkesë që ne e kemi bo vit pas viti ndertimi i kanalizimit rrugën Elena Gjika e kom cek vet edhe kom ngrit si çeshtje mirë që ka hy në projeksion buxhetor edhe mirë që fillon punoj.

Rënovimi i kulmit të QKMF-s kemi qenë bashk dëgjim buxhetor edhe me Fatonin me drejtoreshat e nderueme edhe besoj është më se e novajshme një pjesë tjetër projekteve që vazhdojnë rregull, po ne kemi pas vetëm një telashe domethën prej momentit pare deri më sont ne kemi kërkuar që t'ju jepet prioritet disa investimeve të caktume nuk jemi kundër zhvillimit turizmit të pakten personalisht jo, po njëkohësisht kërkojmë që ato investime që janë më vitale për qytetarët, nëse nuk mund të bëhen para prapakisht, pakten bëhen paralelisht me investimet që bëhen në Bjeshkë, për shembull, po i përmend një gjë, nëse po i zem investimi i kulmit QKMF-s është më se i nevojshëm atëherë unë nuk besoj që duhet të zgjas dy vite. Unë besoj që duhet kryet vitin e parë. Po i zem, ndertimi i objektit të OVL-s nuk besoj që duhet të zgjatet kaq shumë duhet kryer shumë më herët edhe nëse qëllimi është për shembull te largohet pallati i kulturës dhe keto objekte këtu kemi për shembull ndërtimin e objektit komunës, ndërtimin e sheshit pa u heq këtu, nuk besoj që mund të fillojnë 2026 ndoshta do e bartim kështu si kot, po nuk mund të fillojnë në 2026 nëse unë sot abstenoj për ket buxhet, arsyet janë vetëm këto për shkak të prioritizimit te disa investimeve kapitale që unë mendoj që janë më se të nevojshme faleminderit.

Hajdar Sutaj

Orges vetëm te kjo Objekti I Organizatës së Veteranëve na tash e kemi ndarë parcellen dhe tash po hynë në buxhet për here të pare.. jo më falë nuk e di sa e dini që perfaqesuesit I lejohet me ja permend emrin se unë e di si ju drejtohem juve edhe kur të ju jap fjalën, Leotrim, Orges Tafilaj e ka fjalën

Orges Tafilaj

Faleminderit kryesues shkurt ne e kemi votuar pro, pro këtij vendimi A je tu dëgju kryesues?
Besoj se duhet me u sqaru bashkë ne kemi votu pro vendimit për ndarjen e parceles për ndertimin e objektit për nevojat e organizatave të veteranëve të luftë, organizatave të dalave nga lufta. Çka thashë unë nuk ka të mbaj që është projekt i vjetër ai i ri, po ka të mbaj që unë jam që të kryhet sa më par dhe mjetet mos te ndahen 50.000 po e zëm vitin e parë, po të ndahet një pjesë e madhe e mjetëve që objekti të kryhet sa më shpejtë kjo ishte çështja.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë, Leotrim Hadergjonaj e ka fjalën pastaj Blinera

Leotrim Hadergjonaj

Përsëritet për gjithë e për me u lidhë për temën e buxhetit unë dashta me bë një analizë njëerën ma t'shkurt buxhetit këtij viti, për investime të kapitale, për me nda për buxhetin e dy viteve të ardhshme si kronologji, besoj që me pas secili të kuart, nëse ka pas naj keq kuptim ose naj keq interpretim buxheti i vitit 2025, për investime kapitale kan 3.000.000 euro, por realisht janë, janë investu 13.000.000 euro. Me tre milionë euro janë nxënë shumë projekte për të cilat ki drejt me investu edhe me kërku në Ministri të caktume, si të infrastruktures, të arsimit, kulturs për me pas ni, ni kërkesë tillë ti duhet me nda një zotim për me mujt me qit ni projekt, nëse ki projektin të gatshëm po du veç me i përmend nja 3-4 projekte te cilat mua më jepin të drejtën që ka ndodhë një gjë tillë e ki për shembull rrugen Përpleqe fazën e parë ku janë investu mbi pesëqind milionë euro kontratën e ka shit komuna e Deçanit, 90% e buxhetit që është siguruar nga Ministria e ki po flas për këtë vit që është që tu kalu mbi katër milionë euro janë investu në rrugën e Qendrës së Qytetit. Investimet e Deçanit që piknisjen e kanë pas nga komuna, nga zotimi i një pjesë të caktumës së komunës. E ki tre milionë euro pagesa që jan nxerr prej Ministrisë për lotin tre, është pagesa e punë që janë kry në Deçan.

Domethënë, sa komplet vlera e buxhetit u siguru përmes një, një zotimi kjo pagesë. I ki mbi dy milionë euro loti katër, që tash është tu e ndërtu, se shumica nuk i kanë të kuart jo ka qit pesë milion tender, nuk i ka mjetet, aty është mbi kqyrjen e Ministrisë, që është duke I bere mbi kqyrjesi, domethënë është kontratë bashkëfinancim Ministri, Komuna, domethënë është qdo gjë në rregulla aty me të nëse veç analizon.

Ndërsa tash po i kthehem buxhetit për vitin 2026-2028 në këtë buxhet janë projektum disa nga projektet që unë mendoj që nuk është që nuk kanë rëndësi, po du me u nis prej të pares, ndërtimi i urave Vranovës dhe Rastavic veq se sot kompania kontraktuese ka nënshkru kontratë edhe ish dal në teren për me fillu punimet.

Është punë e kryer që është buxhetuar për vitin ardhshëm 500.000 thash e jo 500.000.000 E, nëse kam thonë pesëqin milion ka qenë gabim, po pesëqin mijë është që është investu. I ki kanalizime në 12 fshatra, 70 kilometra. Unë besoj që këto kanë mu kry qysh u kry Rruga e Qendrës, nëse ka fillu me 500.000, janë investu 13.000.000 deri qitash edhe unë besoj që kryetari këta ka mi kry, se ky është një qofë se ka shti në buxhet si kod e siguron mjetet për mi perfundu janë 70 kilometra, 12 fshatra, e ki asfaltimin e mbi 12 kilometra rrugë të bjeshkëve që është bjeshka Pleqe rruga për bjeshkë të madhe edhe një pjesë më të lla. Janë kilometra që jo zotimet e cilat kanë mu kry në bashkëqeversije me Ministri.

Qysh janë kry deri tash i ki përfundimin e ndriqimeve në rrugët publike, të cilat janë përpërfundu dhe që janë tu u asfaltu rrugë të reja. I ki mbi treqind mijë euro të ndame për rregullimin e shkollave në komunën e Deçanit, janë 8 shkolla që ishë dashtë Ministria me bo renovimin e tyre, po tash komuna ka mi kry veç se është procedurat e ndërimin. Ndërtimin e një trotuari në pesë fshatra. Që është besoj projekti më i rëndësi. Besoj se qysh është shumë me rëndësi, memoriali i dëshmorëve mbi hjeshtren e Belegjit, i cili është në këtë buxhet edhe besoj që vetëm... Kjo nuk është jo prej shumë arsye që është mirë me e perkrah. Si dhe fillimi i punimeve për rrugën e Lezgecisë, që lidh nga Luka deri në Lubbarë. Faleminderit shumë!

Hajdar Sutaj

Faleminderit Leotrim, po kryetar urdhëro

Bashkim Ramosaj

Kështu koleg I nderum unë nuk thash diçka tjetër përpos... asaj që është lutja jeme në raport me krejt juve dhe nuk jam këtu për me keq përdorur as informatën që kemi fillu me ura, po thash këto ditë unë sakt jam vetë nënshkruesi I asaj fatkeqësisht pse është shtyr deri tash shyqyr qe kryhet ajo punë e dyta kur po flasim ne keto momente duhet me falenderu nje koleg tonin qe është drejtor per zhvillimin ekonomik këtu qe bashk me nje pjes te kolegeve kemi arrit qe me I pas 3 buxhete prej mekanizmave buxhetor nderkombetar, projekti I par ka me fillu ne qendren rinore qe është nje ambient qe I dedikohet lojrave te femijeve nje kend lojrav nje lloj parku qe e ka vleren 200.000 euro edhe keto nuk jan para te komunes nuk jan para te shtetit tonë, e buxheti I dyt qe ka me shku per turizem e ka vleren me shum se 470.000 euro dhe buxheti I tret qe presim me u miratu është me shum se 560.000 euro me keto 3, 2 te parat jan te garantuara per te treten jam I bindur qe kemi me mrri dhe tash a kemi mundesi me pas ndonje (/...) prej nivelit qendror, une besoj qe po sepse jan disa gjana te nevojshme ne kete diskurs është planifikuar edhe ky buxhet faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit! Blinera Lokaj e ka fjalën

Blinera Lokaj

Faleminderit kryesues përshëndetje për te gjithë sa i përket projektbuxetit, unë po ndalem pak tek projektet që parashihen të ndodhin në regionin e Vokshit fillimisht është për keqardhje që disa projekte po përsëriten vit pas viti, të tilla si ndertimi i objektit të Memorialit të Dëshmorëve në fshatin Dranoc, si dhe renovimi i shkollës në fshatin Voksh, projekt ky i cili figuron në planifikim vit pas viti, por fatkeqësisht nxënësit e asaj shkolle ende vazhdojnë mësimin në kushte të vështira. Ne si regjion përpas vungesës esenciale të ujit dhe pijes, derisa ju, kryetar po deklaroni që nuk është kompetencë e juaja, përpast kësaj problem-problematike, ne kërkojmë që të bëhet funksionalizimi i plantit të ujarve të zeza, ndertimi i trotuareve, asfaltimi i të gjitha rrugicave. Po ashtu, një çështje shumë e rëndësishme është edhe renovimi i qatisë në sallën e sportit në shkollën fillore Syl Alaj në Dranoc. Kurse sa i përket turizmit, po m'vjen mirë që më në fund është e përfshirë në prejll buxhet ndertimi i urave që çojnë në mbjeshkën Plaçica e Vokshit. Këtu kërkoj sqarim, kryetar, cilin statusi aktual i këtij projekti? A ka filluar ndonjë procedurë konkrete, si dhe kur pritet të fillojë dhe të përfundojë ky projekt?

Hajdar Sutaj

Faleminderit Blinera, kryetar a deshiron me u pergjigj?
Kryetari Bashkim Ramosaj e ka fjalën.

Bashkim Ramosaj

E tha edhe drejtoresha Dabinë që na kemi kry procedurat për renovimin dhe mirëmbajtjen e objekteve shkollore. Nganjëherë nuk kemi fat për shkak se ka kompani që e akuzojnë njëra tjetrën e paditin. Shkojnë deri në OSHP dhe i shtyn këto procedura. Ndonjëherë jemi në këtë situatë, por për këta doshmet, në këtë kot buxhetor që duhet me pas një kot buxhetor. Tjetra që këtu bën pjesë edhe shkolla e Vocshit. Një prej tyre janë katër shkolla që e tham jem në këtë xhanje. Sa i përket urave në... rrugën Rezall Trupçë për Tllaqizët e Vocshit, ne kemi bo projektin e gatshëm. Kemi menuar që kemi me hy ma herët në këtë, mmm, këtë kampanjë të ndërtimit tyre dhe nuk, uh, nuk ka ndodhur për shkak ni... situatës që kanë pasur Ministria e Zhvillimit Rajonal, që dihet publikisht ç'ka ndodh. Në rast se, mbramja e aktivitetit, s'po ku arrim me pas ni memorandum bashkëpunimit, jemi ma sigurt, sepse është ni borë e madhe për komunën, ni kosto e madhe e ndërtimit të urave. Uh, jom tepër i kënaqur që bashkëpunoj me këtë ministri, sepse ka ni praktikë të administrimit tjetër. Nuk e ka praktikën e disa ministrive, që momentin kur përfundon viti buxhetor nuk marrin përsipër kurgjo më. Dhe jam ni pjesë e ministrive të linjës, uh, tri katër prej tyre që, uh, e mbështesin, e mbështesin edhe vite tjera n-në vazhdim. Një prej tyre është Ministria e Zhvillimit Rajonal, prej të cilës kemi kërku nim dhimbje të bashkëpunimit dhe financimit të të njëjtëve. N'variantin më t'mirë mundet me u kry procedura ket vit. Nuk besoj se mundem bonu ket vet per shkak të kushteve atmosferike vare prej tyre tani. Ë, mirëpo, uh, jom i sigurt se në rast se kryhet procedura ket vit, vitin tjetër na kemi me vazhdu me punu n'to. E për ujit të pijes, noshta kom thonë erën nuk osht edhe kompetencë. Unë e di unë e di shumë mirë kompetencat që ken në bazë ligjore, profesurise e komunale, ashtu statutit Komunes së Deçanit edhe qenit akcionar nënshtrimit për ni... nënshtrimi. Jemi pjesë e Kompanisë Rajonale Hidrodrini, që ne kemi obligim të ndamë, e kemi disa detyrime ligjore që na duhet me bo ato. Edhe për te i kësaj, e kemi investu kohë pas kohe në, në shumë sidomos nënshtrirjen e retit, e besa besot edhe në akumulim në këtyre ujërave. Vetëm ket vit, sa për dijeninë e ju, ne kemi hap ni trase rruge për rajonin e Vocshit, ku i kemi pas punë të ndera. Ne kemi pas me hap këtë trase rruge, Hidrodrini ka pas me bo investimin zbashku me komunitetin, e kemi kry pjesën tonë. Nuk ka ndodh pjesa tjetër. Besoj që e njejt është, s'po ku kemi, e kemi lobu shumë që rregjioni i Vocshit, sidomos i qelc i fshatit Boberi sh me ne qenë pjesë e projektionit buxhetor nga Hidrodrini do ka hy si projektion buxhetor. Që vitin ardhshem na u ndrru edhe gypa edhe akumulimi ujt mu bo me standard pak mat nalt. Dhe po besoj që pjesën kapush e kemi kry deri në 90%, ku kemi vendos orë, per shkak se pa i vendosur orën nuk mundem me bo këta. Ajo që nuk e kemi bo noshta me shume zhurmë është që kemi vendosur ni gyp prej Urës Demes, që shkon ne drejtim te qendres se fshatit Strellc edhe po mendoj qe kemi me... në çfarë do lloj variante ne rast se rritet kapaciteti, si mas ideo qe kem na, atehere nuk, uh, nuk bojm fjalë për ujt të pijes mo e sikur nuk bojm fjalë noshta për disa tema që edhe munden mu permend kohë pas kohe, qoftë rruga (...) qoftë kanali (...) qoftë vija e Gështënies, ni tregim ni storie jo fort e mirë, sepse kemi qenë në listë zezë me ket-- me këtë pjesë dhe kemi tejkalu ket-- prej (...) aty, nvaret edhe prej buxhetit a mundet me u shty matutje po jemi në situat, në situat, uh, krejt rregull krejt... të mirë, ka mujt me ndodhë ma herët bile kjo ura un kam besuar qe ndodh me heret por nuk ka ndodhur

Hajdar Sutaj

Kryetar, faliminderit shumë!
Po, Arian Dobraj, Albesa Cacaj, Florim Matah kjo është renditja te lajmeruar deri tash Yll a po e mand ne mend Ariani, Albesa, Florimi faleminderit

Arjan Dobraj

Faleminderit kryesues sdi pse po shkon por ne rregull

Jo s'ka lidhje jo po vazhdoj se s'ka problem, po ajo prezente është unë isha duke l thene hajdarit faleminderit që ma dha fjalën para kolegut, Florim Mataj, që ky gjithmonë jep një far mbyllje temav përmbajtësore kështu që kam për nder me e përfunduar edhe unë fjalën time para tij. Meqenëse, uh, meqenëse jemi para kamere dhe jemi me gjasme, po mendoj që mbledhja e fundit e rregullt, mbase mund të jetë, unë vetëm deshta, në mënyrë personale, si asamblist i Kuvendit Komunal të Deçanit, shpreh mirënjohjen e thellë, për kryetarin e komunës Bashkim Ramosaj, bashkë me varsit e tij, për disa prioritete që i kanë dhanë për vitet në vazhdim për fshatin Gramaxhel në emër të banorëve të fshatit Gramaxhel, asiqri, por edhe fshati i Dubravit, i shprehi mirënjohje për prioritizimin e këtyre projekteve që do të zën vend ne projektbuxhetin për vitet në vazhdim faleminderit.

Albesa Cacaj

Po besoj...po besoj, kryesues don mu vanu meqë jemi në transmetim live, dhe qellim është qytetaret me pa punën tone, atëhere po vazhdoj.

Kryetari fillimisht tha ne fund fjalës, para se të shkoj se jemi në rregull me krejt situatën kryetarit du me ja rikujtu se ka 10 miliona euro borxh domethene nuk jon paret e veta, jon paret e taksa paguesve, te qytetareve te Deçanit qe secili prej neve kontribon, qe me u mbledh aj buxhet, dhe aj buxhet me na u kthy ne investime kapitale, po jem i Ldk jemi shum krenar kur kemi argumente edhe te drejte me kundershtu buxhetin nuk e kundershtojmë per pike qefit ose pa arsye, sepse kemi dhon kontributin ton dhe vazhdojm të ja japim duke kontribuar me argumente, me rekomandime, me kërkesa, gjë e cila asnihere nuk meret parasysh është fakt qe ne mandatin e kalum, është ndruar neni në status, ne statutin e komunës së Deçanit, ku thuhet se vendimet merren me shumic votash sa i perket buxhetit, por kryetari duke pas parasysh kete fakt, ai tu e pas parasysh edhe faktin qe e ka shumicen, e ka ndryshu nenin ne favor te tij, qe buxhetin me pas me komandu sikur ti ishte i veti edhe si rrjedhoj, pe thom edhe niher po e ritheksoj e kemi situaten me 10 miliona euro borxh komuna e Deçanit. Kshtu qe kisha dasht shume me kon Kryetari ketu, me ia bo pyetje qysh don me i plotësu ose mi realizu projektet ne vazhdim, kur je borxh? Keta nuk e kemi te qart faleminderit shum.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë, unë veq e përcaktova radhën Florim Mataj e ka fjalën urdhëro zotëri Florim.

Florim Mataj

Përsëndetje, zotëri Sutaj përsëndetje drejtor, koleg asamblist. Sot po diskutojmë për buxhetin 2026-2028. Ashtu siç kisha, siç kam deshiruar unë e gjithë se bashku besoj që kishim deshirën që ta kem një buxhet tjetër, po ky është buxheti, ta kem një buxhet me te madh , po këto janë rrethanat, kelat, gjendet komuna jonë, e kemi një buxhet investime kapitale që shkon rreth tre milione e pesëqind mijë euro. Uh, unë dashta me u nderlidh pak, e kam lexuar me vemendje e kam lexuar buxhetin, buxheti është gjithpërfshirës, ku i prek gjithë sektoret e komunës tone, duke u nis nga infrastruktura, arsimi, shëndetësia, blektoriat, turizmi, bujqësia, dhe ajo çka osht edhe projektet e cilat u diskutuan edhe nga kolegt ma heret. Janë disa projekte në vazhdimsi, besoj që gjithë e kuptojnë se kemi kontrata një vjeçare, dy vjeçarë e tri vjeçarë, që janë kontrata në vazhdimsi. Ajo çka osht lajmi i mirë, osht që kemi nda... Kodin buxhetor që fillojmë me vitet. Vitin 2026 të fillojmë me trajtimin e ujërave zeza, që mendoj që do të jetë një prej prioriteteve të projekteve më të mëdha qe do te ndodh në komunën tonë kete e ceki dhe kryetari në fund të diskutimit në Bankën Botërore, ku do të jetë një projekt që do të mbyllet në atë cikël trajtimi i

ujërave zeza. Çka do t'doja të lidhem me kolegët që unë jam që tetë vite në Asamble e është buxheti i tetë që e votoj. Nganjëherë më shqetëson lajmi kur i dëgjoj disa kolegë me të njëjtën refren që kur para tetë vitet kështu që kur kthehem mbrapa tetë vitësh, shohim që ne Deçan ka ndryshuar dhe ka projekte shumë, shumë të mëdhaja dhe ka një zhvillim që e vren çdo qytetar për dallim nga... Veç pak. Për dallim nga, nga shumë kolegë të tjerë edhe, edhe unë mund të kem vrenjtje. Ndoshta një projekt nuk mundet me qenë në lokalitetin nga vi un po du ta shohim te përgjithshme dhe u diskutua edhe kërkesa e kryetarit besoj që ishte shumë kërkesë e drejt që ta votojmë gjithë së bashku këtë buxhet, kështu që kisha kërkuar nga koleg opozitar se jemi vitin e fundit ta votojmë buxhetin, sepse është buxhet premtus dhe zhvillimor për komunën e Deçanit, kaq kisha.

Hajdar Sutaj

Florim të falenderoj shumë për fjalën, koleg, a keni mundësi me majt qetësi nëse keni mundësi, e kisha luft drejtoreshën për Buxhet dhe Financa Dafina Cacaj me ia dhonë një përgjigje zotris Mon Selmanaj që e ka parashtrur një pyetje në fillim drejtoresha.

Dafina Cacaj

Nuk kam harruar por kam menduar se ka harruar Baca Mon, te pyetja e Bacit Mon ke te të drejtë për shkak se teknikisht u harru por jo në sistem është projekt që ka me u mbyll vitin tjetër është në kontrata në vazhdim e din ti që u kan e kontraktume dhe jan kryer disa prej fshatrav besoj qe kryhet edhe Rostavica te komunalit qe the ne 2028 te pjesa e komunalive qe the është dyfishu ajo është parashikim fillimisht ndersa ndersa ne e kemi propozu nje vlerë tjetër por ministria e financav e ka pru atë shifër nuk e di a kan bërë me qëllim apo gabim, nuk besoj edhe nëse rriten qmimet ende nuk besoj qe shkon ne komunal ajo pjes mirpo për derisa është parashikim ajo ne 2028 ose ne 2027 me planifikim ndryshohet në bazë të nevojës qe kemi me pasë qmimit te rrymes te ujit e keto te tjerat

Hajdar Sutaj

Kështu koleg më falni diqka kuptoj që jeni tu i marrë edhe nga nje kafe e kuptoj që jo nuk është veç në pyetje ajo po është pikë me rëndësi buxheti po nëse keni mundësi meqenëse na i përfunduar diskutimet, unë e kisha qit në votim.

Kush është për buxhetin e propozuar? falemnderit

Kush është kundër? falemnderit.

Kush është abstinim?

Atëherë të nderuar të pranishëm me 14 vota për, me 7 vota kundër, me 2 vota abstenim Kuvendi

Komunal e ka miratë buxhetin për 2026 Urime.

I nderuari kryetar Zoti Bashkim Ramosaj të urojmë punët te mbarë e suksese në vazhdimësi jemi te pika e tretë jo më falni më falni ju lutna për mbanu e lus drejtorin e arsimit, zotërin Besnik Hulaj që ta paraqes njoftimin e Drejtorisë së Arsimit për përgatitjet e vitit shkollor 2025-2026 me degjoni 12 e 10 jemi këtu, ju kisha lutur me bërë një fotografi të perbashket te gjithë anëtarët e kuvendin që jemi këtu jo tani se mund te mos kthehet ndonjë.

Hajdar Sutaj

Zoti Mon, Faruk, Fikri, Florim, a jeni dakord, koleg me kërkesen e juve ne mbajtem nje paus ishte ideja me mbajt 10 minuta I beme 30 jemi tek pika e 3 eshte njoftimi I drejtorin per arsim per pregaditjen e vitit 2025-2026 e kisha lut drejtorin e arsimit Besnik Hulaj qe tu ju drejtohet me njoftim ju lusë ta mbani

qetësin.
Yll a ke mundesi me ndez mikforonin këtu.

Besnik Hulaj

Atëherë mirëdita dhe pershëndete për të gjithë I nderuar kryesus drejtor komunal asambleist, para se me marrë fjalën edhe me tregu për raportin në fillim të vitit shkollor 2025-2026, kisha pasë një fjalë rasti për juve ndeshta mi falënderu të gjithëve për kontributin që keni dhanë këto vite për të mirën e Komitetit tonë dhe Deçanas, të mirën e arsimit, të mirën e përgjithshme ndoshta kemi pasë edhe naj... keqkuptim mes veti ndër këto 4 vite po nese kam bere ndonjeher nuk ka qen me qellim fjalë.

Mirpo gjithçka ka qenë për të mirën e komitetit tonë fillimisht, Drejtoria e Arsimit në bashkëpunim me të gjitha shkollat e komunës së Deçanit ka bërë përgatitjen e nevojshme për fillimin e vitit të ri shkollor 2025-2026 sa i përket infrastrukturës dhe kushteve mësimore ambientet e brendshme dhe të jashtme të të gjitha shkollave janë pastuar dhe dezinfektuar nga stafi teknik profesional i trajnum për këtë punë të gjitha shkollat komunës së Deçanit janë furnizuar me dru pelet për ngrohje dhe janë furnizuar kryesisht në mujin korrik dhe gusht para fillimit të vitit të ri shkollor shumica e shkollave kanë qenë gjendje të mira, gjendje pranueshme, mirpo disa shkolla të cilat edhe ne i kemi tenderu dikun ka qeshori për renovim, mirpo për shkak të procedurave që janë sidomos prej ankesave me OSHP, ende nuk kemi mujt me përfunduar si procedurë. Me të nderim për për ndertim ose renovimin e shkollave janë: Shkolla Sulejman Vokshi e Prejlep Ardhmëria në Belek, Deshmorë e Vokshit në Poberc, Gjimnazi Vllaznit Frashëri, Shkolla profesionale Tafil Kasumaj, Paralelja e ndarë në Dubrovnik, Paralelja e ndarë në Voksh, Lidhja e Prizrenit tash veç është në ndertim ata nuk kemi mujt me e shti në renovim, është në ndertim, po ashtu edhe qerdha që është në ndertim e sipër në fshatin Carabregu projektet dhe investimet të reja që i kemi paraparë në shkollat tona Nxënës të shkolles (...) këtë vitë gjithë kanë fillu në objektin e ri shkollor është bërë edhe demolimi i objekteve të vjetra po ashtu edhe renovimi i sallës i fushës së edukates fizike është paraparë edhe ndertimi i fushës për edukatën fizike i sallës së sportit plani zhvillimor komunal i arsimit siq e dini të gjithë ka kalu ketë vit edhe përmes Asambles Komunale, dhe është ndër planet zhvillimor komunale më të mira në nivel Kosovë ku prej të cilës është kujdes edhe ish-ministri profesori Ramë Likaj. Tek regjistrimi i nxënësve, edhe ket vit kemi pas ngritje të numrit të nxënësve klasë të parë janë regjistruar rreth katërqind nxënës numri i saktë konfirmohet në sistemin SMIA, i cili është i hapur deri më 20 tetor ky është numri që ka qenë për momentin i evidentum, ndersa në klasë të dhjetëja janë regjistruar dikun rreth treqind e tredhjetë nxënës ka pas ngritje por të dhenat nuk na dalin deri me 20 tetor rezultatet e nxënësve sa i përket kalueshmërisë, në testin e arritshmërisë klasat e 9-ta është 53 përqind ka qenë i kneqshëm, ndersa kalueshmëria e testit të maturës shtetërore ishte mbi 90 përqind në ta dy afatet këtu kemi qenë ndër komunat që kemi qenë me se miri në nivel Kosovë me kalueshmëri ndersa sa i përket trajnimit dhe zhvillimit profesional të stafit arsimor vitin shkollor 2024-2025 janë trajnuar rreth mbi 350 mësimdhënës me programet e akreditura nga MASH-i, duke shfrytëzuar kredit për procesin e licencimit e rilicencimit dhe këtu si komunë Nivel Kosovës jemi ndër komunat e para që o kry komplet stafi arsimor janë licencuar ose rilicencu. Procesi i licencimit ose rilicencimit është kry me se pari në komunën e Deçanit sipas të gjitha dhanave që janë në nivel vendi. Rrekutimi i stafit, Rrekutimi i stafit tash na obligohet gjithmon me ni her n'vit të hapen konkurset që janë paraparë ofrt vendet e lira apo diçka tjetër është kryer Furnizimi me tekste shkollore këtu pak kemi pas probleme, sepse furnizim me tekste shkollore u bo përmes subvencionimit, subvencionimit të prindërit, gjë që ka shkaktuar vonesa në pajisjen e nxënësve me libra nuk është varur gjithçka prej neve është varur gjithçka prej aplikimit të nxënësve pranimit, konfirmimit nga ana e shkollës, se çdo shkollë e ka pas nga dy koordinatore një për klasen 1 deri në 5, një për klasen gjashtë deri në 9 gjithë ata që kanë apliku, ata janë pajisur me libra, mirpo vonesat ka pasur te blerja e tyre. Problem kanë hasë kur njëri prind ka qen shtetas i Shqipërisë, sidomos kur ka qenë... kur kanë apliku ata që psh kemi pas rastin që kanë qenë nënat nga Shqipëria edhe aty kemi pasur shumë të lashte të sovencionimi edhe problem ka pas te fëmijët që janë binjak, sepse ne te dalinjtë e kane nxjerre telashe edhe aty te sovencionimi i librave te përfshirja e nxënësve me nevoja të veçanta në sistemin tonë paraniversitare të arsimimit ka qenë i kënaqshëm na kemi arritë që t'i kemi 17 asistente për fëmijë me nevoja të veçanta edhe pse numri i fëmijëve është më i madh e mbulojmë si fush komplet.

Siguria dhe parandalimi i braktisjes në shkolla këtu kemi pas disa probleme sidomos me me minoritetet është dhënë rëndësi e veçantë siguria në shkolla me bashkëpunim të vazhdueshme të Policisë së Kosovës dhe drejtorët komunalë të shkollave nga Drejtorët e shkollave është kërkuar angazhim me ekipet e tyre për parandalimin e braktisjes në shkolla edhe lobimi kundër efekteve negative që sjell braktisja kam bërë edhe ligjerata, edhe nga ana jonë po edhe nga ana e policisë ligjerat për mos braktisje të shkollor sepse vazhdimisht hasim në telashe me ata fëmijë ose nxënës që bëjnë braktisje në shkollë, sepse që çka shkon nga ana negative e tyre. Në përgjithësi jemi mirë shkollat janë gjitha funksionale të paktën kemi pasur probleme me shkolla paralele të ndara që e kemi katër po kryesisht problemet i kemi me numrin e vogël të nxënësve edhe proporcionin mesim si në rëndësi edhe nxënësve. Nëse ka dikush diçka me pyetje rreth raportit.

Hajdar Sutaj

Drejtor faleminderit shumë është lajmruar Arian Dobraj, Mon Selmanaj dhe Albesa Cacaj pastaj Orgesi, drejtor mundesh me u ulë mundesh me I marr pyetjet edhe mundesh me u përgjigj në fund ose

Arjan Dobraj

Faleminderit kryesuesë e falënderoj drejtorin Besnik Hulaj për raportimin lidhur me fillimin e vitit të ri shkollor 2025-2026 fillimisht deshta me falenderu sepse është po ajo që tha drejtori sepse DK-aja kujdeset që shkollat tona të jenë të përmbushur në çdo element qofte nga siguria, qofte nga përmbushja me staf, nga rekrutimi sidomos kohët e fundit kemi pasur nevojë edhe për asistencë për fëmijë me nevoja të veçanta kështu ka qenë kanë reagu DK-aja dhe i kanë sjellë për përkujdesin e tyre. Unë vetëm e pata një hall sepse di që edhe DK-ja ka reaguar shumë me ven që ka reaguar jo vetëm DK-ja jonë po gjitha komunat të pjesa e librave që është varur nga sovencionimi nga qeveria ku thuhet në vendimin e Ministres Nagavci se për klasat 6 dhe 9 duhet të ndahen vetëm nga 80 euro edhe ka kërku që librat bazë të këtyre klasëve të merren eventalisht nga nxënësit e kaluar ose kur nuk premtuan numri të blinin të reja. Ata që kanë marrë nga nxënësit e kaluar, domethënë janë detyruar me punu me botime të vjetra, kurse këta nxënës që s'ka premtu numri klasë para prake me i marrë libra tjere, kanë punu me botimet e reja, të cilat janë me ndryshime shumë të dukshme sepse vetë jam mesimdhënës edhe hasi ndryshime të jashzakonshme të mësimëve të njësive mësimore kur i hapim librat jemi duke bisedu për një temë nëse është botim 2021që e kanë marrë gjysma e klasës, kurse ata që e kanë blerë e kanë marrë botimin 2024-2025 domethënë jemi te e njëjtat temë po me diferencime të shum të mëdhaja edhe kjo mendoj që ka me kon problem nëse nuk reagohe, sepse e di që tash o vonë për kit vit shkollor, po nëse nuk reagohe nivel shteti së pari po edhe nga drejtorit arsimorë nëpër komuna që duhet të ndryshoj kjo, sepse është komplet e pakuptimtë edhe po shkon normal në dëm të nxënësve për të cilat absolutisht nuk ka faj as DK-ja po as ne si mesimdhënës vetëm se po hasim në telashe të perditshme faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Arian, drejtori e ka fjalen Besnik Hulaj

Besnik Hulaj

Edhe njëherë të falënderoj shumë për pyetjen Arian është e vërtetë se kemi pas edhe kemi hasë në vështirësi jemi ndër komunat e para që kem reagu për sovencionimin e librave në këtë formë unë i kërkoj falje të gjithë atyre prindërve sidomos atyre që kanë ndrru kur kjo prej klasë klasë, sidomos prej klasëve gjashtë, shtatë e kështu me radhë shumicën e klasëve kim pas numrin më të madh të nxënësve edhe

gjith ata prind që s'kanë pas ku me I marr librat tash me kompenzu me libra te ish nxënësve më herët është dashur mi ble krejt te reja. Normal që gjitha librat e vjetra kanë qenë edhe të përshkrume edhe të shënume libri është diçka personale dhe normal nuk eshte dashur mu dorezu fare sepse një herë osht, o diçka personale duhet me ruajt për ton jetën, nashta ka qejf me majt si kujtim atë libër kemi has ne veshtiresi te mdhaja jemi mundur me be zgjidhje prej shkolles ne shkollë, po prapë skemi mundur mi mbulu te gjitha sepse vetëm një klasë Prejlep kan qenë 9 nxënës ma heret tash janë katërmëdhjetë e dashtë te gjith te tjeret mi ble librat

Hajdar Sutaj

Drejtor faleminderit, Moni pastaj Albesa Mon Selmanaj e ka fjalën

Mon Selmanaj

Faleminderit kryesus I nderuar drejtor në pikën 9 të raportit tjuaj pasusi i fundit thuhet: Nga drejtoret e shkollave është kërkuar angazhim me ekipet e tyre për parandalimin e braktisjes së shkollës dhe lobimin kundër efekteve negative që sjell braktisja dhe nuk kemi as ni fjalë rreth migrimit të nxënësve dhe problemeve që dalin me migrimin e nxënësve nëpër shkolla nëpër klasa edhe veçanërisht rreth sistemimit pastaj të vendevët punës së mësuesve a mund te na jepni ndonje apo ndonjë raport ma te detajuar rreth kësaj pike? Falemnderit.

Besnik Hulaj

Faleminderit për pytjen zotëri Mon migrimin e jashtëm nuk mundemi me ndalu supse është proces që po ndodh jo vetëm në Deçan por në gjitha shkollat e Kosovës ni raport që kemi nxjerrë janar 2024 janar 2025 kanë qenë 64 nxënës që kanë migruar jashtë vendit edhe dy mësimdhënës ndër ta problemi është që nuk kanë qenë gjithë nxënësit nga ni klasë edhe nuk kemi pas probleme sa i përket mësimdhënëve për rehatimin e tyre ose plotsimin e normës tyre sa i perket mësimdhënësve u kon mir, sepse ndoshta u kon një fëmi në klasë ose dy fëmij një klasë mirpo klasat janë tmushun gjitha me nxënës skemi pasur telashe me norm sa i perket numri i mësimdhënësve ndërsa u kon pak jo e mirë për neve me dal 64 nxënës që me migru jashtë vendit me 82 mësimdhënës, mirpo process që po ndodh niveli vendi.

Hajdar Sutaj

Drejtor Faleminderit, Albesa ..jo prite radhën

Albesa Cacaj

Duhet fillimisht si Asamble si shoqni mu pjek edhe me e kuptu ni send shumë qartë momentin që e mer poziten edhe detyrën e ki obligim ligjor e moral me kon në kry të detyrës unë nuk e kuptoj kurrë se kom kuptu as niher pse e kan te nevojshëm disa koleg këtu mu shpreh me lavdata e falenderime që ke bo punën që je bo I zoti mfa! po ti në momentin që ki mar punën e ki detyrë edhe obligim ligjërisht edhe moralisht edhe paguhesh e para, e dyta drejtori i arsimit, tash tek ti pytja ke kështu po prit e ke konstatu ose ke shkru se ekipet e tyre për parandalimin e braktisjes së shkollës jemi të vedishem secili prej neve e mas shumti unë që e kom ngrit këtë çështje në Asamble tu marr parasysh që jem edhe anëtar e Komitetit

për Komunitete së bashku me anëtar tjer që disa herë ose së paku një herë në vit ose dy herë dalim nëpër shkolla sidomos në fillim para fillimit të vitit edhe konstatojm gjendjen në teren nga drejtori i shkollës përkatëse që ka braktisje ky është fakt që nuk mundemi me e mohu po çka kemi bo ose çka keni bo si Drejtori e Arsimit në lidhje me ndërmarrjen e masave që kjo dukuri mos me u zvarrit ose mos me u përfundu po mu zvarrit prej vitit ne vit nje situatë tjetër që mra në vesh nga ti drejtor e këta po e thom për hire të interesit te publikut, është që Shkolla Fillore Lidhja e Prizrenit ne Deçan, ka fillu të ndërtohet nga viti 2019 pra te njëjtën kohë me shkollën Gramaçelit, Shkolla Gramaçelit është përfundu fëmijët vijnë në mësimin Shkolla Lidhja e Prizrenit është në gjendje tmjerueshme po fatmirësisht që ka fillu objekti por objekti është dasht mu përfundu ma heret e këta pe thom kur e pava edhe te projeksionet buxhetore të viteve paraprake edhe e pash që rinovimi i shkollës Vokshit prej 2023 mos me kon gjendje as sekretari as drejtorja e arsimit me ndërmarr masa për mu evitu ajo situat tu e marr parasysh se rinovimin muni me e pas n'kompetencë e keni kompetencë ndryshe nga ndërtimi që arsytoni që është kompetencë edhe delegim i Ministrisë së Arsimit faleminderit shumë!

Hajdar Sutaj

Albes faleminderit na japim kritika edhe vretje kolegët po edhe nëse kanë ndonje herë lavdata nuk ka dert ..drejtor

Besnik Hulaj

Faleminderit Albes për pytjen edhe pse ne pyetje je kon shume e pakjart se unë ti deshe bo pytje jo përgjigje ti pytje me bone mu na po llogaritem prej braktisjes ne shkolla edhe ti edhe na e dimë që janë dy komisione është komisioni nga ana e shkollës për parandalimin e braktisjes ku përfshihet drejtori me një staf të shkollës edhe një është brenda komunës ku komuna bashkë me Policinë e Kosovës me Qendrën për Punë Sociale bashkëpunojmë bashkë dhe çdo familje që femija i tyre bon braktisje brenda asaj shkolle çdo rast domethënë i përkushtohemi dhe çdo rast trajtohet e para.

E dyta sa i përket kësaj teme arsimit parafillor do thotë prej klasës së parë deri në 9 është i obligueshëm edhe qdo prind para ligjit ka përgjegjësi ne nuk mundemi me marr me qu me zor as prindin as ata ne ju drejtohem institucioneve qdo prind jep raport per femijen e vet telashe kemi pasur sidomos me minoritetet sepse ne momenti qe per 6 muaj nuk i qojshin femijet ne shkoll nuk mundeshin me marr as socialin mirpo ligji e parasheh ashtu ndersa te lidhja e Prizrenit edhe un edhe ti jemi deshmitar qe ajo ka pasur mu lshu jo tash por para 5 viteve problemi ka qen se ne pandemi shumica e firmav qe kan punur eshte dashur me deklaruar diqka ajo firm punkryese qe u kan ne ate shkoll ajo nuk ka mundur me ju mbajt atyre rregullave qe i ka pas ministria ka deshtu si projekt, projekti ka dal nga ministria me vones 3 vjet me vones as ministria nuk ka pasur diqka keq aty por kontraten e ka pasur 3 vjeqare nuk ka kryer as nje pune dhe pas 3 viteve ju ka nderpre kontrata tash eshte tender nga ministria e ka marr nje punkryes i cili i kryen punt besoj ti je tu shku shpesh se i ke edhe femijet aty eshte duke i perfundu punet shum shpejtë edhe besoj para 1 shtatorit ka me qen e perfundume ndersa te renovimi i shkollave sidomos ata qe e ceke ti ne Voksh jo se nuk ka nderhy komuna, ka nderhy sidomos ne renovimin e tualeteve komplet ne projektin e renovimit te shkollave jan dikund 9 shkolla ne komunën tonë nder nto qe jan pak me keq Prelepo Belegu Vokshi te gjitha kan pasur me perfundu gjat pushimit qysh e kemi parapa mirpo ankesat e kompanive fituse dhe atyre qe kan fituar ne OSHP jan te paperfunduara sepse ankesat ne OSHP i kan ndalesat e veta e kan Kohen e vet nuk nvaret qdo gje nga ne Faleminderit.

Hajdar Sutaj

Drejtor faleminderit Orgesi është pastaj Vatani

Orges Tafilaj

Faleminderit kryesur gjithë nxënësve dhe mësimeve urime për fillimin e vitit të ri shkollor unë kisha një çështje që e kam ngritur edhe herë të tjera edhe me qenë se qenka edhe drejtori Izet ndoshta mundet me na ndihmu është mëse e nevojshme vendosja e pasqyrës së komunikacionit në kendin e shkollës në fshatin tona në Lëbush, për shkak se tashmë edhe qarkullimi është shtuar edhe është rrezik për sigurinë e nxënësve dhe prindërve që frekuentojnë shkollën. Faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Orges Drejtori i Sërbimeve Publikë Izet Zenuni e ka fjalën.

Izet Zenuni

Përsëritet kryesur Asamblesit dhe Drejtor është e qartë rreziku të shkolla juaj është parapamë tash edhe në këtë projekt buxhet që është votuar sot të gjitha institucionet shkollore duke përfshirë edhe Shkolla Lëbush prioritet është masat e sigurisë rreth saj qoftë me pasqyrë ose me pengesa në rrugë, qoftë me treqar dhe me rrethoja vitin e ardhmë d.m.th. projektbuxhetin që u votua sot kanë me i pasur.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë drejtor Vatan Istrefaj e ka fjalën, Zt. Selmanej puntë të marë suksese ju prift e mara

Vatan Istrefaj

Faleminderit për fjalën kryesur drejtor kam vetem një pyetje të shkurtë e cila edhe më herët që ke angazhuar disa asistente për të ndihmuar fëmijët me nevojat veçanta kam edhe kërkesa këtu prej prej prindërve të këtyre fëmijëve që kanë nevojë për trajtim shtesë asistentet që janë aty shumica e kohës ma shumë po merren me nxënës që vijojnë mesimin në formë të rregullt sesa fëmijët me nevoja të veçanta e kisha jep si vërtetë që shkon ky rekomandim tek ato asistente po ashtu drejtor a kemi ndonjë plan për fëmijët me autizëm? A mundemi me pat në ndonjë shkollim shtesë apo të veçantë? Faleminderit.

Hajdar Sutaj

Vatan Faleminderit Drejtorit a keni mundësi me ja ndez mikrofonin

Besnik Hulaj

Faleminderit për pyetjen Vatan fillimisht, asistentëve që kemi angazhuar për fëmijë me nevoja të veçanta në komunën tonë na si komunë kemi pas numrin shumë ma të vogël por kemi arritur me pasë edhe më shumë se sa numri i fëmijëve me nevoja veçanta është 45 po perkujdesi i asistentëve ndaj fëmijëve me nevoja veçanta është një komision që bën vlerësimin e fëmijëve me nevoja të veçanta është brenda komunes ka edhe psikolog asistente, është një zyrtar i DKA-s edhe kur ta bën vlerësimin e këtyre fëmijëve brenda shkollave vlerësimi bëhet prani të prindërve të atij fëmije kujdestarit ose mësueses që e kanë edhe drejtorit shkolles gjithçka parashihet në atë vlerësim dërgohet një raport te prindërit te shkolla edhe te ne në DKA ata e vlerësojnë që ai fëmijë nëse mundet me qendru komplet gjatë gjithë orarit në shkollë, e vlerëson Komisioni dhe na e zbatojmë atë raport Komisionit. Nëse Komisioni parasheh që ai fëmijë oshtë, po llogaritim autik ose është hiperaktiv dhe e pengon procesin mësimor, ata parashohin që të mund të majt një orë, dy ose tre gjethqka nvarët nga femija çdo vlerësim është korrekt, është në prezencë edhe të

prindërve ose kujdestarit ligjor që e ka fëmija. Për sa i përket qendrës së Autizmit, është temë e rëndë edhe është temë ndishme edhe na si komunë nuk mundemi me pas me organizime me se pari skemi kapacitetin për të organizuar e le më me ndertu nje qender për autizëm. Kanë qenë disa projekte edhe prej Ministrisë jemi tu prit nese nuk janë komunale, me konë regionale, po është e mira me kon ka shumë fëmijë autik edhe në Deçane edhe çdo komunë tjetër.

Hajdar Sutaj

Drejtor faleminderit shumë po e them atë që na kritikoj kolegja, po me të vërtetë si drejtori edhe si institucion edhe ju edhe kolegeve drejtorav edhe mësimsdhënësve te pergezojm per angazhimin që e boni urojmë sukses vitë të mbar faleminderit per njoftimin.

Kolegë jemi te pika e katër që është Përkrahja e Kuvendit të Komunës Deçanit për deklaratën e datës 19 Nëntor 2024 dhe komunikatës mbështetëse të datës 16 korrik 2025 mbi eliminimin e gjitha formave te dhunes ndaj grave në politikë dhe jetën publike në Kosovë sa informim këtë deklaratë e ka mshtet Kuvendi i Kosovës dhe pastaj ne kemi qenë të organizuar nga OSBE-ja me një takim bashkë me kryesues të Kuvendit Komunal të rrafshit te Dukagjinit dhe koleg asamblista që po ashtu i kam dhënë mbështetje po për me e lexu deklaratën mbështetëse e pastaj edhe për me e miratu ose mi dhan mbështetje e kisha lut kolegen Yllarta Thaçi që te del në foltore meqenëse ka qenë edhe bashkëpjesmarës që bashkë me Albesën dhe me Blinierën e me të tjerë në këtë ngjarje faleminderit.

Yllarta Thaçi

I nderuari Kryesus kolega Asambleistë nga të gjitha subjektet politike Drejtor përfaqësues të OSBE-së që jeni sponsor të kësaj pike të rendit të ditës media me shkas po flas dhe lexoj deklaratin mbi eliminimin e të gjitha formave të dhunes ndaj grave në politikë dhe jetën publike në Kosovë isha prezent në nënshkrimin e kësaj deklarate në nivel regional bashkë me koleget Albesa Cacaj e Blinera Lokaj njëkohësisht edhe me kryesuesin e Asambles Z. Sutaj me datën 16 korrik të vitit 2025. Kësaj deklarate duhet t'i japim mbështetje sepse konsideroj se dhuna ndaj grave në politikë në punë apo në jetën publike është një plagë që dëmton gjithë shoqërinë tonë. Ne duhet t'u japim grave të drejtën edhe mbështetjen që meritojnë, duke mos ju mohuar dijen, rolin dhe vlerën që ato kanë. Gruaja nuk është vetëm një numër ajo është një vlerë forcë dhe urtrësi që e pasuron politiken dhe jetën publike. Gruaja duhet të jetë me pjesëmarrje më të lartë në vendimmarrje, sepse një grua di te udheheq di te edukoj breza të tërë ndaj duhet të ketë hapsirë dhe vend më shumë në shoqëri që ti jemi të barabarta. Do i lexoj deklaratën mbështetëse ne anëtarët e Kuvendit të Komunës së Deçanit shprehim mbështetjen tonë të plotë për deklaratën mbi eliminimin e të gjitha formave të dhunes ndaj grave në politikë dhe jetën publike në Kosovë, te miratuar nga deputetët e partive të ndryshme politike të përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës gjatë legjislaturës së 8. Përmes këtij qëndrimi mbështetës Kuvendi i Komunës së Deçanit i bashkohet zërit të deklaratës së datës 19 Nëntor 2024 dhe komunikatës mbështetëse të datës 16 Korrik 2025, të nënshkruar nga anëtarët e Kuvendit të Komunës së Rajonit të Dukagjinit, duke përforcuar kështu frontin e përbashket për ti dhënë fund dhunës ndaj grave në politikë dhe jetën publike. Le ta miratojmë këtë deklaratë si një hap të drejtë një komunë ku barazia, respekti dhe përfshirja e grave nuk mbetet vetëm fjalë, por shndërrohet në vepra konkrete për një të ardhme më të drejtë dhe më të sigurt për të gjithë. Faleminderit!

Hajdar Sutaj

Yllarta faleminderit shumë nëse e vlerësoni mos me pas debat e kisha qit direkt ne votim Kush është për me miratuar deklaratë kunder nuk ka abstenim nuk ka konstatoj që Kuvendi Komunal mënyrë unanime e ka mbshtet deklaraten ose e ka përkrahur deklaraten mbështetëse për parandalimin e çdo forme dhunes ndaj grave në politikë dhe jetën publike të Kosovës. Kolegë kemi shti si pikë rendit te dites plotsim

ndryshimet ne rregulloren per organizimin e mbrendshem dhe sistematizimin e vendeve te punes ne administraten komunale ne me datën 4 shtator kemi pranuar disa rekomandime nga Ministria përkatëse me disa rekomandime sa i përket votimit që kemi pas të rregullores e kisha lutur zotërin Enver Cacaj që ta merr fjalën dhe të na i shpjegojë propozimet e rekomandimit të Ministrisë të cilat na sot duhet mi bo si ndryshime. Enver edhe koleg ju kisha lutur ta dëgjojmë.

Enver Cacaj

Faleminderit kryesues për fjalën Përshëndetje te gjithë anëtarët të Kuvendit ashtu si e potencojnë pika te shkurtat edhe kryesusi me aprovimin e rregullores ne mbledhjen e kalume (....) i ka kthyer disa rekomandime ku rekomandimet nuk na jepen asnjë obligim ligjor janë rekomandime që mundemi inkorporuar ose mos me inkorporuar sipas rekomandimeve që (..) I kan leshuar eksperti që është i angazhuar per atë çështje i ka inkorporuar ato rekomandime. Rekomandime kanë qenë ne fushën te pozitave e Kuvendit ka qenë te Avokati Komunal rekomandimi kanë qenë te Drejtorit i (..) ndërsa sa i përket rekomandimit që thotë është kundërshtim ose duhet me organizimin e Administratës shtetërore të Agjencive të Pavarura ashtu qysh e kam potencuar edhe në KPF, mundet kur kemi që na hin dicka në punë mundem mu thirr ne ligjin për organizimin dhe funksionimin e Administratës shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura mundet domethonë rekomandimet që i kanë lshu (..) janë inkorporu në rregullore sa kemi mujt me e përcjell materialin ose me e lexu pak u kon me vones edhe në KPF që e kemi diskutu at dit ka mbet qe Dyka me ju përcjell anëtarëve të Kuvendit nuk munda me ditë është lexu material apo jo rekomandimet që janë lshu nga (..) janë inkorporu në rregullore diçka tjetër nuk ka, faleminderit.

Hajdar Sutaj

Kështu e para ka qenë kërkesë në Komitet për Politikë e Financa sepse ka qenë obligative për me trajtu na sepse ju e dini që Ministria na jep afatin kohor brenda tridhjetë ditë edhe na e kemi qit në këtë seancë, sepse edhe materiali ka ardhë me vones besoj ju ka ardhë ne email ndërsa për shkak që mos me e printu gjithë materialin na jemi ra dakord ne mbledhje KPF-se se vetëm ka një per subject politik per me ja dhene kisha pasur qef me bo ni pyetje para se me marr Florimi fjalën a mundesh me na tregu çka ka rekomandu Ministria për çështjen e Avokatit te Komunës? Per cilat pozita ne kuvend? Qfar ka rekomandu për QPS keto konkrete qfar kan thene qfar duhet me be ndryshim?

Enver Cacaj

Sa i përket Avokatit të Komunës na si rregullore është parapa me kon ne kuader te Drejtoris për Administrat me arsyje sepse pozita e Avokatit Publik Komunal është pozitë profesionale, nuk është pozitë udhëheqëse na e kemi parapa me kon bashkëpunim me sektorin ligjor ose zyrën ligjore (...) ka rekomandu me kalu në kuader te zyres se kryetarit me i raportu drejtëpërdrejtë kryetarit të komunës sa i përket pozitave të Kuvendit ka rekomandu që të largohen pozitave përkthyesit dhe lektorit me arsyetim sepse janë të parapara ne Drejtorin për Administrat kur brenda Organizatës Buxhetore i mjafton ni përkthyes ose ni lektor. Ndërsa sa i përket QPS ka rekomandu titullimi drejtor te hiqet e kemi diskutu edhe më herët sepse është pak edhe logjikshme ka qenë më herët drejtor në kuader te Drejtorisë për Shëndetësi. Drejtori i QPS kur është marrë nga ni drejtori e kemi titullu si udhëheqës sektorik te Qendrës për Punë Sociale.

Hajdar Sutaj

Kështu nuk ka diçka mbaz asaj që po e vërej ndryshime përmbajtësore për shkak se nëse është hekë përkthyesi dhe lektorii po është ne kuadër të administrates është gjithqka me rregullt nëse është larguar

emri si drejtor është udhëheqës prap se prap është ni menaxher atje. Avokati i komunës nëse.. a ekziston zyra ligjore?

Enver Cacaj

Është zyra ligjore është e qysh kanë rekomandu a pet e kemi vendosur në kuader të Zyrës Kryesore te Komunes.

Hajdar Sutaj

Në rregull domethënë avokati shkon ashtu në rregull, Florim Mataj e ka kërku fjalën nëse ki mundësi Enver me qendru per mu pergjigj ça kan pyetje, Florim Mataj ka fjalën, Florim nëse ki mundësi afro mikrofonin.

Florim Mataj

E kemi diskutu edhe në Komision Politik e Financa e kemi krejt pak arsye atje tu diskutu, pak ndryshime le t'ju vinë edhe kolegëve tjerë por nuk pe sho që ju kanë ardhur, kështu që sa i përket at ditë kemi ra dakord si komision që ta përcjellim për asamble edhe për votim kështu që nuk po shof diçka veç se për ndryshime që ju i keni bere jan plotsuar një kërkesë ndoshta e pata te (...) a ka ndryshu numri l punetorve apo eshte diçka tjeter nuk kem keshtu qe me ato dy pozita qe jan larguar nga kuvendi qe nuk na ka japur te drejt mi pas edhe dy lektorin dhe perkthysin ne administraten komunale kshtu qe arsye edhe ne komision e kemi diskutu ndoshta pak me vones ka qenë neglizhenc e administrates qe nuk ka ardhur materiali tash nuk po du me hy ne atë na kemi kerkuar te gjith qe te jet sot ne kuvend dhe ta percjellim per shkak qe per nje neglizhenc ndoshta ..jap mbeshtetje.

Hajdar Sutaj

Enveri pate diçka per te shtuar pastaj drejtoresha Agnesa Vokshi

Enver Cacaj

Florim siq e potencove nuk kemi për me e gjujt topin kush është fajtor ose sështë fajtor e është logjik edhe duhet të pranu ni fakt kur është dërgu pak materiali me vonesë pak a shumë jam munduar atë ditë ne komiteti për politike financa rrjedhën ose ecurin pse ka ardh materiale me vonesë unë i kam diskutu me Dyken ka thonë që kryesusi e kemi bo rendin e ditës nuk e kemi nënshkru po e diskutojmë a me shti si pike të rendit të ditës unë e kam proven materiale ku e kam prezantuar atë ditë në KPF që e kom dërgu te Zyra e Kuvendit, Zyra e Kuvendit nuk e kish dërgu as në KPF me pretekstin tha që unë nuk e dërgoja asnjë materiale ose diçka pa e marrë një dritë të gjelbërt prej kryesusit ose kryetarit decitivisht kështu u kon e potencuar. Domethënë nuk jom për me e gjujt topin ose fajin dikun e kemi mbyll, është ardh pak me vonesë, kërkojmë ndjes unë po ju kërkoj ndjesë është ardh pak me vonesë sa keni mundur me lexu nuk e di ndryshimet pak a shumë keto sipas rekomandimeve jonë inkorporu në rregullore.

Hajdar Sutaj

Po faleminderit shumë.

Enver Cacaj

Une qato rekomandime që janë kon të nevojshme janë inkorporu në rregullore që i kemi pa të arsyeshme që mundem me i inkorporu.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Drejtoresha Agnesa Vokshi, pastaj Albesa e ka fjalën drejtoresh urdhëro.

Agnesa Vokshi

Falemnderit kryesus fillimisht Enver faleminderit për sqarimin edhe unë për me qenë pak ma sqaruse ndaj Qendrës për Punë Sociale po du me e bo një pyetje ndaj teje.

Unë i kam edhe rekomandimet që i ka dhënë Ministria përkatëse ku thotë që qendra për punë sociale duke qenë se kjo qendër është një njësi organizative e vendosur në Drejtorin për Mirëqënien Sociale atëher duhet të shtohet një paragraf që përcakton se kjo njësi është barazvlefshme me sektor. Pyetja jeme është kjo çka e kanë shkruar ata a po e thu ti që duhet të hiqet emërtimi për drejtor? Apo e ka specifiku Ministria që duhet të hiqet emërtimi për drejtor?, për shkak se Ligji për Shërbime Sociale parasheh që Qendra për Punë Sociale duhet me pas drejtorin. Veç ta kem qartë edhe une. Faleminderit shumë!

Enver Cacaj

Fakt me te drejt e kemi diskutu edhe pa e qit në leximin e parë se Ligji për Qendrën për Punë Sociale e cek (..) duhet të ketë drejtor ndërsa sipas rekomandimeve ata kanë kërku që, ka thonë njësia apo emërtimet tjera të njërive që nuk quhen sektor, duhet të shtohet një paragraf që përcakton se njësia është e barazvlefshme me sektor është e shprehur në sektor njësia apo zyrën rregullore janë të përcaktume. Nuk po dojm na mu paraqit që jemi më të meqëm ose që nuk dime po edhe pse është nivel qendror munet me pas shpeshher gabime ose në interpretim. QPS-ja është, janë dy sektore Sektori për Punë Sociale dhe Mirëqënies Sociale emërtimi si drejtor është larguar ka mbet udhëheqës i Qendrës për Punë Sociale, domethën vetëm si emërtim që i bije e njëjtë është, veç që nuk e ka drejtor e ka udhëheqës rregullor kështu e kemi parapa se fakt ashtu qysh e kemi potencu apet paraprakisht para se rregullora me dal, e kemi pasë temë diskutimi qe ligji për qendren per pune sociale thot, QPS-a duhet te ket drejtor ligji si ligjë po (...) ka thonë që nuk bon me pas asnjë drejtor, domethënë udhëheqës i sektorit për qendër për punë sociale.

Jo absolut rekomandimet në fund nëse i keni pas thotë Departamenti për Menaxhimin e Zyrëtarve Publik, Ministria e Punëve të Brendshme shpreson që komentet e lartëshenuara të ju ndihmojnë në finalizimin e kësaj rregullore domethënë ti apet munesh me vendos si Kuvend qysh ta shihni të arsyeshme me i lene pozitët ose emërtimet.

Hajdar Sutaj

Koleg unë po du për me thonë kështë që Albesa, Moni edhe Florimi paten më shtu edhe diçka dhe jom i interesum që gjithsecili me jap mendimin e juaj sepse tek fundit na jemi për me e bo në mënyrë më të mirë të mundshme por prapë se prapë ish dasht me qenë brenda kornizave ligjore qfar do që është urdhëro Albesa.

Albesa Cacaj

Përshëndetje për zotri Enverin atëhere kryesus deklarove që është ardh me 4 shtator unë menoj që nuk e di kush duhet me marrë përgjegjësin po besoj që ai që e ka bo këtë veprim ose mos veprim duhet mu thirr në përgjithësi, që me 4 shtator me mbri ky dokument e mos mu shpërndau me kohë sepse na po dalim jo mirë si asambleista. Unë nuk muj me jap mendim ose rekomandim, me qenë se nuk kom arrit me i lexu ne kohen sa na erdh këtu në kuvend përveç që muna me thonë që ato çka i potencoj Enveri te lektyrimi, te perkthimi dhe te zyrtari ligjor, unë kam qenë kundër edhe në mledhjen e parë kur në seancën e parë kur u dasht me u votu edhe i kom jep argumentin pse jom kunder kështu që tash nuk po mundem me jep mendim ose vlerësim sepse nuk e kom lexue gjithsesi faleminderit!

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë, materiali ju ka ardhur me vonesë sepse nuk ka hyrë në rend të ditës e vërteta është sekretarja e Kuvendit më ka pyetë edhe unë i kom thonë që të pyete kryetarin meqënë se shumica e ktyre temave kanë të bëjnë me administratën edhe pastaj ka ndodh kjo si ka ndodhur edhe kemi ardhë në mbledhje të KPF-s që ka ardh Enveri qysh e spjegoj edhe na kemi rene dakord si KPF me diskutu edhe me propozu me rekomandim që mu fut ne rendin e ditës edhe i kom thonë që me ju dorëzu ne mënyr elektronike kolegët e anëtarëve të Kuvendit por po duket se nuk ju kan ardhur tash e juaja është me vlerësu si doni me procedu më tutje, Enverin e falënderoj që e spjegoj detajisht për cilat bëhet fjalë edhe unë personalisht e ndaj mendimin që ta mbështes domethënë këtu sugjerimes. Nëse ju mendoni ndryshe, atëherë na qesim në vote Mon Selmanaj e ka fjalën.

Mon Selmanaj

Unë kam një pyetje për ju konkrete, jo me këtë mendimin qellimor që është pjesë e Ministrisë së Puneve të Brendshme me datën 27.12.2024. Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal ju ka dërgu shkres njoftuse kryetareve te komunave per kete rregullore e cila thot permes kesaj shkrese njoftuese ju bejme me dije komunav se para zgjedhjeve.....

Hajdar Sutaj

Na e kemi diskutu edhe atëhere po propozimi ka qenë me e qit në votim, sepse na kemi pasur mundësi edhe me e qu përpra me marrë mendimin e tyre pastaj me ardhë për aprovim po ka qenë kërkesa me e qu mos po miratohet kështu Florim a pate diqka me shtu, Arian Dobraj urdhëro.

Arjan Dobraj

Vetëm deshta ta pyes Enverin shkurt se ky vlerësim që ka ardhur për këto pozita, te pozita e emërtimit të drejtorëve I QPS-s a është diqka e prer apo ne ende mundemi ta kemi nje propozim të tillë që te emërtohet si drejtor I QPS-s

Hajdar Sutaj

Për me plotësuar Arianin ky është duke thënë nëse ne e lëmë drejtor te Qendres per punë sociale a na kthehet negative a po jo, do të thotë kete eshte duke e thene

Enver Cacaj

Keto Arian janë komente rekomandime na prap mundem me lon titullim Drejtor a na kthehet A nuk na kthehet nuk mund të ju garantoj nuk mundem me garantu, unë mendoj që e kemi diskutu edhe mbledhjen tjetër rregullore për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, që nuk krijon vende të reja të punës qita punëtor që i kemi me mujt mi sistemu qita punëtor që jan me koeficient dobët, me I avancu pak më koeficient nuk kemi rregullorja nuk e atakon interesin e përgjithshëm publik. Qytetarit i ofron mi ofru ti shërbim qysh organizon ti institucionin e nëse ti je në gjendje me 50 puntorë 50 angazhoj veq domethënë nuk është rregullore që atakon interesin e përgjithshëm publik as ni ministri ose nuk e shini agjensi që man debatet publike edhe ata bijnë nga njëher në desh me vetveten. Nuk është rregullore që atakon interesin e përgjithshëm publik. Është rregullore mrena për mrena organizimit te brendshëm, ku deri me tani e kem vendim nuk e kemi rregullore. Vendin e kemi edhe është organizuar.

Hajdar Sutaj

Kolegë kështu na nuk mundemi për me jep mendim për gjithsecilin drejtoresha është këtui mundet me jep rekomandimin e vet sa I përket Kuvendit po du me e përsërit e jona ka qenë me qenë ma funksional për Kuvendin a jonë ata në zyrat të Administratës, a Komunës me rëndësi mi shërby Kuvendit edhe shpresoj që nesër nuk kan me thon: "Ne s'kemi obligim ndaj juve". Kur ka nevojë Kuvendi, qata zyrtar përdryshe a janë sistemu në drejtori te Administratës po me rëndësi me kon edhe në funksion të Kuvendit, në raport me obligimet edhe punët edhe kërkesat e nevojav që i ka Kuvendi Komunal Drejtoreshë... në lidhje me këtë cili është mendimi yt për Qendrën për Punë Sociale?

Drejtoresha, Agnesa Vokshi

Pas pak telashe ndoshta edhe me ata qe besoj se jemi munduar me jau sqaru edhe unë kam kërkuar nga Enveri me qenëse ligji e parashehë ashtu, ashtu na me lënë dhe propozimi im është me lënë emërtimin drejtor qysh e parashehë ligji për punë sociale nëse një ligj e kish parapa ndryshe kisha kerkuar diqka te till sido që të jetë Enveri është profesionist I fushës mundem me kuptu dhe interpretu pak më mir se ne sido që të jetë propozimi im është ky që po e them tashë.

Hajdar Sutaj

Florim, unë e mora mendimin e drejtoreshës edhe të këtij po du me e pas po dhe tëndin edhe gjithsecilit pop o.. Florim Mataj ndezja mikrofonin.

Florim Mataj

Rregullorja më herët që na ka kthy mu plotësu kështu që nëse dojm me vazhdu prapë me fotnan dëshirash prapë ka me na kthy kjo ke e imja se naj kemi propozu edhe në kuvend e e din sa e kemi bere stafin na ka kthy, nuk ti ka leju e kemi drejtu ka qenë me pozit drejtorit ku ka shku dhe ka kthy me qenë pozitë udhëheqës. Tash na dojna me vazhdu prapë. Na thonë i (....) vetvetë. Dojm me thonë i dojmë drejtor kaq që në aspektin ndoshta edhe te gjith drejtorit quhen këshilltarë. Edhe në aspektin kur u kthy këshilltarët e kryetarit të komunës. Kështu që unë jom për me e qu ashtu sysh na ka kërku. Kjo oshtë e imja. Per anda kom kërku në Komision politik e financa që të hyj.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë Drejtori i Administratës, nëse ki ni mundësi me ja ndez mikrofonin po don me pas ni diskutim, Drejtor afro mikrofonin.

Drejtori i Administratës, Jashar Dobraj

Faleminderit me qenë se u hap debat rreth rekomandimeve që kanë ardhë nga niveli qendror, rregulloria në fjalë është rregullore e brendshme e Kuvendit Komunal, funksionimit të brendshëm të Administratës Komunale dhe njëkohësisht niveli qendror ka sjellë vetëm rekomandime. Ka sjellë rekomandime aty ku i ka pa të arsyshme, po nuk i ka nuk janë rekomandime të detyrueshme të obligueshme. Në vendimin fjalë thuhet pe citoj vendimi zero ni numër pesë thy për gjashtë, për miratimin në parim të rregullorës draft rregullorës për organizimin e brendshëm të Administratës komunale. Thuhet që vendet e punës në Administratën Komunale nuk i nënshtrohen shqyrtimit të detyrueshëm të ligjëshmërisë se tek është pak e shlyme më vlej me të lexova, po osht vendim vendim që e ka. Vendimi nuk i nënshtrohet. Po unë deshta veq edhe një çështje se nuk e përfundova rasti i drejtorisë së shëndetësisë mireqenisë sociale këtu pat kollazion të ligjeve pat ndërhyrje ligji ndaj ligjit. Derisa ka ksi elementesh atëhere duhet duhet të përzgjidhet cilin ligj osht ma funksional dhe në bazë të atij ligji veprohet përndryshe, kur ka ndërhyrje ligji në ligj nuk janë të integruar me kohë.

Enver Cacaj

Me pagë moshën e pensionit me hyrë në fuqi ligjit e pagave, ajo ka pasur koeficientin 7.22 si pozitë e nivelit. I ulët drejtues nuk e ka pasur koeficientin sikur drejtues të drejtuesit komunalë, po koeficienti i ka qenë pozitë e nivelit të ulët 7.22. Domethënë, as ligjin e pagave nuk oshtë...Pagan si pag e kom fjalën e kam marre si nivel i ulët drejtues, edhe pse titël në vendet kun si ka pasur drejtues i peses si pagë osht ku ekuivalent me nivelin e ulët drejtues.

Hajdar Sutaj

Enver të falënderoj shumë edhe ty edhe gjithsecilin që dha kontributin unë mendoj që me qit votim rekomandimet e Ministrisë për me i përkrah ashtu qysh janë ardh.

Kush është për?

A ka kundër?

A ka abstenim?

Konstatoj që me 18 vota për dhe dy vota abstenim, e kemi miratu rekomandimet e Ministrisë sa i përket rregullorës për punë të brendshme sistematizimin e vendave të punës. Enver falemnderit shumë suksese. Koleg jemi te pika e fundit e ndryshme kolegu Vatan Istrefaj ka thonë se kam pyetje për drejtorin e Sërbimeve Publike e ka fjalën i pari

Vatan Istrefaj

Falemnderit shumë, kryesisht drejtore zakonisht kur kemi pyetje për ty, zakonisht shkojmë për ndriçim publik dhe asfaltimin e rrugor dhe rrugicav siç e din drejtor ka qenë kërkesë e I mja e perseritur disa herë që të bëhet edhe ndriçim i publik në një rrugë të fshatit Strells I Epërm për të cilën konkretisht rruga Miftar Povataj ka qenë edhe premtim nga ana jote, do të bëhet për këtë periudhë brenda muajit shtator, pasi që tani po përfundon edhe kontrata për ndriçim publik, ndriçim public drejtor nuk ka përfunduar ende në atë pjesë a ka mundësi me na japë një përgjigje dinjitoze për këtë? Po ashtu pati edhe një

kërkesë së bashku kemi biseduar edhe më herët me drejtoreshën për Buxhet dhe Financa e kemi një bashkëfshatari cili ka për të bërë një intervenim në kokë ka një intervenim neurokirurgjikë dhe i duhen mbështetje jonë financiare nëse ka mundësi drejtoreshë me atë sa ke ka kompetenca Zyrë e Kryetarit për te ja ndar një fond buxhetor të bëjmë një vendim për këtë punë, pasi që është një pjesë e madhe edhe na prek gjithsecilin nga ne Faleminderit!

Hajdar Sutaj

Faleminderit Vatan drejtori Izet Zenuni e ka fjalën.

Izet Zenuni

Faleminderit për pyetjen Vatan është edhe e saktë në muajin qeshur e kemi pas premtim që rruga Miftar Përvataj edhe rruga e Istrefaj njëkohësisht edhe fshati Dubovik, Lumardhë edhe Prapaqan duhet me perfundu me ndriçim publik arsyeja që skemi mujt me ardh deri te përfundimi është që, komuna nuk ka mujt me krye obligime kompani për shkak të bllokimit të sistemit edhe jemi këtu ku jemi. Kompania nuk ka kry punë pa e pagu na pa ja kry obligimet edhe jemi këtu ku jemi mua më vjen keq që nuk kemi mundur me ndejt koherent me premtimin por ky është realiteti

Hajdar Sutaj

A pate edhe nje pyetje diqka

Dafina Cacaj

Po na sot edhe e kemi pas familjarët në takim e kemi marre një iniciativë se osh vlera e bukur e madhe ata kanë kërku për mes tyre qe me dalë në qender një ekip edhe me kërku mjete financiare qe sa më shpejt qe të munet mu grumbullu mjetet edhe me qu për trajtim sa aty vynë 22.000 euro e zyra e kryetarit po ka kompetencat e saja edhe sa më shpejt qe tmunen me i kry procedurat teknike edhe me i dalë mjetet e nuk është naj telashe.

Hajdar Sutaj

Drejtoreshë faleminderit Miftar Ahmetxhekaj e ka kërkuar fjalën.

Miftar Ahmetxhekaj

Faleminderit shumë kryesus realisht tre pyetje i kam, dy me gjasë një e kom për drejtorin për shërbime publike, është një kërkesë për dy rreth rrotullimit më saktësisht në Isniç, te i pari dhe i dyti, po ma me theks te i dyti. Drejtor siç e dini aty edhe si rreth, si diametër është koça problematik për shkak se deri sa t'i afroresh shumë afër nuk ta krijon përshtypjen e një rrethi e para dy ditë ka ndodhë një aksident edhe kogja me permasa te mdhaja ka mujt me pasë fatalitet. A kishim mujt aty e kom një kërkesë edhe prej banorëve të familjes Haka, që janë në anën djathtë të rrugës po edhe të dy bizneset që janë Ing dhe Roshkodoli, cilat janë mundësitë ose a ka problem mi vendos disa pengesa ose cilat janë mundësitë reale për me marrë masa ne këto dy rrethe për ta evitu rrezikun? E pyetjen e dytë nuk e di sa është trajtu e kom pak me drejtoreshën per buxhet dhe financa nuk e di në kuptimin ligjor saktë deri sa ka mundësi kryetari i komunës me da prej zyrës së tyre për rastet më të veçanta ka të bëj me nji familjar te fshati i Isniç, i cili

para disa kohe e ka pas një zjarrevënje në objektin po e quaj në shtallë, po përveç që iu ka djeg objekti ati ju ka djeg edhe komplet produktet ose sana që e ka pas ne ato objekte përcjellëse. A ka mundësi zyra e kryetarit me ni shumë, sado simbolike, me qenë se edhe ashtu jemi në ballë të dimrit. A e ka ni kogja kopëd, nëse nuk gaboju dhjetë diçka. Komuna e Deçanit ti dal në ndihmë blegtorit në fjalë. Fjala është për Agim Shabanin nga fshati Isniç. Tretën e pata për drejtorin për Urbanizëm, me qenë se nuk qenka këtu unë mundem me adresu si kërkesë, por nuk e di a është brenda afatit ligjor ka të baj me harten zonale a mundesh drejtor me dhan ndonje informatë deri ku ka shku komuna e Deçanit me harten zonale Falemnderit shumë.

Hajdar Sutaj

Drejtori i shërbimeve publike e ka fjalën.

Izet Zenuni

Falemnderit Miftar është te pengesat ne rrugë ne si komunë pavarësisht në shumicën e fshatërave kemi praktikuar edhe kemi qit aty ku kemi pas munds para tre muajve ka ardh një shkres një udhëzim prej Ministrisë së Infrastrukturës, do të thotë prej Drejtorisë së Rrugëve, aty ku duhet me vendos pengesa paraprakisht na duhet me marrë një raport prej policisë që brenda një viti a ka pas aksidente, qoftë me fatalitet, qoftë me dëme materiale edhe me marrë ni far forme izën për me vendos ni pengesë të tillë, te rrethi i Isniçit është shiqu me bo sikure kemi bon ne Carabreg do të thotë te hyrjet, te ato dyja në momentin që fillojmë me asfaltimin e rrugës, pjesën deri te Strelci mu vendos sikur janë ne praktikë Carabreg ne te dy rrethet neper fshatrat ta kemi qartë është kërkesë e madhe shumë prej njerëzve, sidomos prej kandidatëve për Asamble prej qytetarëve, prej kryetarëve komuna, kryetarët e fshatërave. Po nuk patë raport prej policisë brenda një viti që ka pas aksidente ose fatalitete, ose dëme materiale, e kemi problem me vendos ni pengesë ne perjashtim te shkollat do të thotë prej shkollave që janë institucionet e sigurisë që merret për bazë edhe pengesat edhe pasqyrat edhe trotuari edhe këto. A te Isniçi është kjo është parashikim qe me e bon te pjesa e tjetër po unë si informat atje është për fshatra tjera, po te rasti i banorit të Isniçit ta kemi unë Shabani, do të thotë, ne si komunë e kemi, e kemi si drejtori, do të thotë është bo raporti për të është bashkë me inspektoren për rendajtjen ndozor osht rasti edhe në prokurori. Po, ndërkohë qytetar ka lirinë, një raport shtesë me dërgu në ministri, për kompensim. Ne e kemi përgatitur raportin, po ne si drejtori nuk mundemi e caktu vlerën e demit duhet ekspert, e dytre fusha për me përcaktuar vlerën e demit. Ne kemi dërguar raportin Ministrisë së Financave. Shpresoj që kanë me ju përgjigj, po ndërkohë edhe një kopje është e dërguar te Zyra e Kryetarit që në te ardhmën mund të subvencionohet diçka.

Hajdar Sutaj

Po drejtoreshë urdhëro drejtoresha Dafina Cacaj e ka fjalën

Dafina Cacaj

Po vetem dashta me sqaru ne lidhje se e kemi pasur edhe nje rast qe e kemi subvencionuar ka pasur dame zyra e kryetarit e ka mundesin vetem deri ne 1200 euro ne i kemi ndar permes KPF-s nje vlerë pak më të madhe për një rast tjetër ndoshta është me mir aj me raport me bashkangjiti kerkesen edhe me pasë ne KPF ne seancën tjetër kur te eshte nese ka me u mbajt me votu tani edhe pse jo sado pak me ja ndihmu

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë Syl Balaj e ka fjalën, Vatan Istrefaj, Blinera Lokaj pastaj Albesa Cacaj ju kisha lut keni edhe pak durim

Sylë Balaj

Atëherë pershendetje edhe njeher

Hajdar Sutaj

Kolegë nuk e kam mbyllur ende seancën

Sylë Balaj

Thujse të njëjtën kërkesë kisha edhe unë për Agim Shabanaj po atëherë i bashkangjitem kërkesës së Miftarit një kërkesë për drejtorin e shërbimeve publike e kamë për urën e(...) dihet se janë tu përgatitur disa rrugë për asfaltim a e keni paraparë zgjerimin e urës edhe vendosjen e parmakëve se dihet shkalla e rrezikshmeris së asaj ure drejtor edhe këto rrugë kur të asfaltohen a e keni paraparë të jenë të gjitha me ndriçim publik faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Sylë, Drejtori i Shërbimeve Publike Izeti e ka fjalën.

Izet Zenuni

Faleminderit për pyetjen është se gjitha rrugët që janë gjatë këtyre ekzekutu punimet në momentin që bëhet asfaltimi do të bëhet shejzimi emërtimi do thotë jan parapame komplet mu kry te rrugat te urat te drumit telit, do të thotë është momenti që kemi me hi me punu te lagja Osmane deri poshtë prashihet edhe zgjerimi edhe vendosja e masave te sigurisë.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Vatan urdhëro

Vatan Istrefaj

Faleminderit kryesus drejtor një pyetje shtesë deri kur është afati i kontratës për asfaltimin e rrugëve dhe rrugicave në të gjithë territorin e komunës së Deçanit po ashtu, kryesus kerkoj falje se nuk i kemi përshëndet ende zyrtar të OSBE-së faleminderit që qëndruan sot me ne gjithashtu, kryesus pasi është seanca e fundit para zgjedhjeve lokale pra që do të mbahet. Faleminderit edhe nga ana juaj ekzekutivit,

gjithashtu nga të gjithë përfaqësues të Asamblesë Komunale. Besoj që kemi qenë një legjislaturë korrekt edhe që kemi punuar për të mirën e qytetarëve. Gjithashtu dihet se mandatin e ardhshëm do të ndryshojë edhe struktura, pasi që kjo seancë do të udhëhiqet nga Lidha Demokratike e Kosovës në krye me Jeton Mushkolaj Rrespekt faleminderit!

Hajdar Sutaj

Unë nuk e paskam ditur që aj pretendon me qenë kryesus, kështu do ta organizoj edhe një séance përshëndetse Blinera urdhëro, drejtori izet Zenuni e ka fjalën, Blinera Lokaj pastaj faruki pastaj Albesa

Izet Zenuni

Do të thotë kontrata e rrugëve dhe rrugicave në komunën Deçanit është lidhur me muajin prill, të këtij viti. Do të thotë afati i dinamikës së punimeve është për tre vjet tani varet me me plan dinamikë të punimeve, po për tre vjet e ka afatin kohor që duhet me përfundu.

Hajdar Sutaj

Falemnderit drejtor, Blinera.

Blinera Lokaj

Po faleminderit pyetje për drejtorin Izet Zenuni, pyetja ka të bëjë me mungesën e tabelave për emërtim të rrugëve tabelave të dëmtuara pra që kompania që e ka për detyrë i ka tërheq mirpo ende nuk i keni sjellë të rejat për shembull në fshatin Sllup rrugë Selman Lokaj tash në tetorë bëhet një vit prejse ne nuk e kemi tabelën drejtor a mund të na informosh se cilat janë hapat apo deri në cilën fazë ka shku komunikimi juaj me kompaninë e cila e ka për detyrë me rregullu këtë çështje?

Hajdar Sutaj

Falemnderit Blinera, drejtor..

Izet Zenuni

Edhe ne mbledhjet e kaluara rreth emërimit të vendbanimeve apo rrugve e ne si drejtori kemi lidhur kontratën me një kompani që për emërtimin dhe vendosjen e tabelave në gjithë lokalitetin e komunës së Deçanit, do të thotë që ni muaj është vendosur. Menaxheri i kontratës sbashku me kompaninë edhe me kry pleqt e secili fshat kanë dal në teren edhe kanë bo inqizimin e terenit edhe kanë marrë të dhënat edhe i kanë dërgu në kompani. Kompanija është e Prizrenit shpresoj se shumë shpejt kanë mi pru tabelat e reja. Do thotë edhe emërtimi i rrugëve po do të bëhet edhe emërtimi i vendbanimit të gjitha fshatrave edhe në hyrje edhe dalje edhe tek kryqëzimet do të thotë besoj që nuk vonojnë shumë tash edhe kanë me ardh.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë, Faruk Hasanramaj e ka fjalën.

Faruk Hasanramaj

Atëherë përshëndetje për gjithë e pata një pyetje për drejtorin Izet te lagjja në fshatin Lubush te lagjes Adrijaj anën e poshtme ku është ura e kanë një kërkesë aty kanë bo murin mbrojtës po e kanë ni kërkesë me e vazhdu se krejt ato vërshimet edhe kur bjen shi ujnati e zeza po mledhen aty edhe e kanë një kërkesë për me e vazhdu murin mbrojtës edhe një njëzet metra dikun minimum a e kem naj mundesi me me bo diqka faleminderit

Izet Zenuni

Për atë që osht tu vazhdu për Strelc duhet me pa me menaxherin e kontratës te punes shtes sa mundet me vazhdu at pjes e cila...ndoshta është e domosdoshme për qytetar, por duhet me pa me menaxherin e kontratës, i cili e dinë sakt në pozicionin sa mundemi me rezervu ose me e shfrytëzu me punë shtesë.

Hajdar Sutaj

Drejtore faleminderit, e ka fjalën Albesa Cacaj nëse eventualisht është nxan me buzqeshje le të fol Ariani .. Urdhero Albesa

Albesa Cacaj

Po faleminderit kryesues ka të bëjë me çështjen që e ngrita në fillim seancës dhe me diskutimin ose kërkesën transparencën që drejtova karshi drejtoreshes për financa. Është fakt që drejtoresha ka qenë ne muajin qershor nëse nuk gaboje ose korrik kur është ardh korniza afatmesme buxhetore edhe e ka dëgju komitetin për komunitete edhe në fund me siguri t'plotë, ju tham që është deklaruar kështu, ju bëni kërkesa, ju inkurajoj me bo kërkesa, po nuk ka buxhet për mss me zgjatë cilat kërkesa i përfshive në buxhetin e vitit 2026 nga radhët e Komitetit për komunitete? Faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Drejtoresha Dafina Cacaj e ka fjalën

Dafina Cacaj

Po na kemi majt një takim para kobit me komunitete, i kom marr kërkesat e tyre e kemi pat një debat buxhetor me 04.08 me komunitete për cilën nuk u mbajt u dasht mu anulë është dëshmitarë edhe Orgesi se jemi kon këtu, po nuk janë ardhë as anëtar të komitetit, Komiteti për Komunitete, as banorë të përfaqësues të tyre lokaliteteve takimin që e keni organizuar me buxhet, atëherë edhe pse u kon vonë, një është shtyr te premtën nuk e di për cilën arsye e keni shtyr se deri kam ardh unë ka qenë i anulim u majt në fillim të javës tjetër. Unë jam vonu dhjetë minuta ti je shku edhe unë e kom majt me komunitet kërkesat e tyre kanë qenë një muri mbrojtës me botën, një shtpi për shkak se ujërat e shiut po e dëmtojnë ndriçimin publik edhe kanalizim një pjesë shumë të vogël, sepse e kanë të krye ndriçimin publik edhe kanalizimin i kemi futur në buxhet ki mujt mi lexu ka e lexove ma herët, ndërsa te murin mbrojtës është një pjesë shumë e vogël si kanal kish mu bë se jam shku e kom pa vetë dillën e kalume për së afermi gjendjen edhe e kemi kshyr me Inxhinierat është ni kanal, nuk është as mur i mbrojtës që ka mu kry shumë shpejt se mundemi me kry me kontratë nuk ka pas nevojë me u përfshirë në buxhet. Unë kërkesat e tyre qato që i kam pas i kom përfshi buxhet jam munduar mu tregu shumë transparente ndaj

tyre pavarësisht që tash jemi në fushat edhe normal që na konvenon ndoshta me u mundu pak njëni tjetrit me ja lënë fajin. Po nuk është në rregull se unë asnjëherë nuk kom thonë nuk ka buxhet për juve, sidomos për ty Albes kom shumë respekt dhe kom qejf fjalën me mi transmetu shumë direkt kur unë i thamë qashtu qysh i tham faleminderit kryesus!

Hajdar Sutaj

Kështu po ka drejtë replike po unë po du me ju thonë në sen që me të vërtetë me të vërtetë kini drejt në ato që e thuani me u perfshi në projekt po me të vërtetë besoj që po e kuptoni që sa buxheti i komunës së sa janë nevojat e qytetarëve, Albesa urdhëro se e ki repliken.

Albesa Cacaj

Sa i përket respektit të njëjtin respekt e ndaj personalisht për ty po profesionalisht besoj e nderuara Dafina ka 12 vitet që jam pjesë e Kuvendit dhe asnjëherë nuk ka ndodhë, pavarësisht ndryshimeve pikëpamje politike, të shtojë ose të mungojë ose të ndryshojë diçka për interesa personale ose partiake edhe pas 100 viteve, nëse jemi gjall kur tham diçka qëndëroj mbase asaj domethënë që ti deklarativisht ki thonë kështu edhe kjo ta arsyton më së shumëti mungesën e Komitetit për komunitete në mbledhjen publike që është dasht mu mbajt domethënë ata nuk e kanë pas besimin me ardh me ti shfaq kërkesat duke arsytu veprimin e tyre që ka vite që e përcjellin në projektet, buxhetet. Këta kërkesën për këtë murin mbrojtës pastaj lagjen pëmishte e ndriçimin që ish fut tash në projekcionit. Nuk e mungojnë ata që e sho ose që e arsytojnë. Nuk e mungojnë me thonë nuk është bo ish hi, regullimin e një gypi nuk e pava kerkund domethënë kjo duheni ju si ekzekutiv me reflektu. Jo jo, personalisht nuk e kam me ty, po e kam me mënyrën qysh procedoni si ekzekutiv duheni me reflektu, mi marrë parasysh kërkesat që edhe qytetarët me kon ne gjendje me ardh me besimin edhe mu majt në mbledhjet publike. Se na e dijmë drejtoreshë edhe jemi dëshmitar që edhe mbledhjet publike

Hajdar Sutaj

Në një minutë e pate, një minutë.

Albesa Cacaj

Veç ta përfundojë.

Hajdar Sutaj

Jo por u bënë 2.

Dafina Cacaj

Mbledhjen publike kur e mban ty të vinë veq ekzekutivi jo qytetart.

Hajdar Sutaj

Më falni, më falni.

Albesa Cacaj

Unë mundem me konstatu këtë gjendje.

Hajdar Sutaj

Kështu më degjoni 1 minut, po dua të ju them që është shumë, un e thash nje send Drejtoresh të lutem më degjoni 1 minut.. Albesa, Albesa... kështu kolegë me të vërtetë kërkesat që I permendi ka të drejtë plotësisht janë të nevojshme buxheti është ky që është aq ka pasur mundësi janë përfshireë disa projekte disa perfshihen ne vitin tjetër qdo lokalitet të gjitha kërksat e tyre nuk janë përfshirë nuk kemi ne asgjë I rrespektojmë shumë jo.. I rrespektojmë komunitetin në fjalë nuk kemi asgjë kundër tyre kemi bërë punë për ta ti e din edhe vet që janë bërë punë ka edhe tjera me u bë në emër të Zotit shkojnë duke u bërë kadal dal. Meqenëse nuk ka të paraqitur të tjerë per fjalë unë gjithsesi nëse jemi shëndosh e mirë do të organizoj edhe një seancë në tetor por gjithsesi faleminderit per te gjithë punën që e keni bërë këto 4 vite edhe uroj në keto ditë të mbetura me qenëse ne jemi edhe përfaqesues të subjektve politike ta kalojmë sa më mirë me një fushat dinjitoze edhe mos të kemi asgjë personale domethanë te garojmë me program me kultur qysh na ka hije edhe si qytetarë edhe si zyrtarë, mirë u takofshim.